



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.125

1 gusht

2008

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Ligj nr.9960 datë 21.7.2008	Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe shoqërive zvicerane Andre & Cie, Uzimex, Fluka Chemie, Ficher Chemicals, Ciba-Geigy (Novartis), Finagrain, të përfaqësuara nga zoti Edmond Kërliu, për riskedulimin e borxhit të prapambetur, që do t’u paguhet këtyre shoqërive”.....
	5519
Ligj nr.9961 datë 21.7.2008	Për ratifikimin e “Marrëveshjes së huasë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD) për financimin e projektit “Përballimi dhe zbutja e rrezikut nga fatkeqësitë”.....
	5521
Ligj nr.9962 datë 21.7.2008	Për një shtesë në ligjin nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.....
	5532
Ligj nr.9963 datë 21.7.2008	Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.9376, datë 21.4.2005 “Për sportin”, të ndryshuar.....
	5533
Ligj nr.9966 datë 24.7.2008	Për disa shtesa në ligjin nr.9396, datë 12.5.2005 “Për qiranë financiare”, të ndryshuar.....
	5534
Ligj nr.9967 datë 24.7.2008	Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr.4, datë 9.7.2008, të Këshillit të Ministrave “Për privatizimin dhe dhënien në përdorim shoqërive tregtare dhe institucioneve shtetërore të ndërmarrjeve apo objekteve të veçanta, mjeteve kryesore dhe mjeteve të xhiros së këtyre ndërmarrjeve”.....
	5535

Ligj nr.9968 datë 24.7.2008	Për miratimin e aktit normativ, me fuqinë e ligjit, nr.6, datë 16.7.2008 të Këshillit të Ministrave “Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit European, për pjesëmarrjen në operacionin ushtarak të Bashkimit European për menaxhimin e krizave në Republikën e Çadit dhe Republikën e Afrikës Qendrore (Operacioni EUFOR Tchad/RCA)””.....	5536
Ligj nr.9970 datë 24.7.2008	Për barazinë gjinore në shoqëri.....	5540

LIGJ
Nr.9960, datë 21.7.2008

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE SHOQËRIVE ZVICERANE ANDRE & CIE, UZIMEX, FLUKA CHEMIE, FICHER CHEMICALS, CIBA-GEIGY (NOVARTIS), FINAGRAIN, TË PËRFAQËSUARA NGA ZOTI EDMOND KËRLIU, PËR RISKEDULIMIN E BORXHIT TË PRAPAMBETUR, QË DO T’U PAGUHET KËTYRE SHOQËRIVE”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe shoqërive zvicerane Andre & Cie, Uzimex, Fluka Chemie, Ficher Chemicals, Ciba-Geigy (Novartis), Finagrain, të përfaqësuara nga zoti Edmond Kërliu, për riskedulimin e borxhit të prapambetur, që do t’u paguhet këtyre shoqërive”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5838, datë 29.7.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

MARRËVESHJE
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
SHOQËRIVE ZVICERANE
(Andre&Cie, Uzimex, Fluka, Chemie, Ficher Chemicals, Ciba-Geigy (Novartis, Finagrain)

NË LIDHJE ME RISKEDULIMIN E BORXHIT TË PAPAGUAR
PËR T’IU PAGUAR SHOQËRIVE ZVICERANE

PËRFAQËSUAR NGA Z.EDMOND KERLIU

Marrëveshje e datës ____/____/2008, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë (këtu të quajtur “Këshill”), përfaqësuar nga Komiteti Qeveritar për Negocimin e Borxhit të Jashtëm të Shqipërisë (këtu quhet “GCNEDA”) dhe shoqërive zvicerane, të renditura në nenin 1 më poshtë, të përfaqësuara nga z.Edmond Kerliu.

Neni 1

Objekti i kësaj Marrëveshjeje është riskedulimi i borxheve, që rrjedhin nga transaksionet tregtare të përfunduara gjatë viteve 1990-1991, ndërmjet shoqërive zvicerane dhe ish-Ndërmarrjeve Shtetërore të Tregtisë së Jashtme.

Shuma e borxheve është si më poshtë:

Nr	Emri i shoqërisë	Shuma e borxhit
----	------------------	-----------------

		Principali	Interesi & Gjoha	
		CHF	USD	USD
1	Andre & Cie		5 014 435,21	449 521,87
2	Uzimex	29 300,00		
3	Fluka Chemie	56 219,00		
4	Ficher Chemicals	73 328,00	102 657,50	
5	Ciba –Geigy (Novartis)	676 312,55		
6	Finagrain		328 708,67	
	Totali	835 159,55	5 445 801,38	449 521,87

Neni 2

Këshilli do të shlyejë borxhin sipas shumës prej CHF 835 159,55 dhe USD 5 895 325,25, në një këst, sa më shpejt të jetë e mundur dhe jo më vonë se 30 qershor 2008.

Neni 3

Këshilli do ta paguajë interesin mbi shumën e borxhit në pajtim me nenin 2 të kësaj Marrëveshjeje, me një normë interesi prej 2% në vit për periudhën që fillon në datën e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje deri në datën e shlyerjes.

Neni 4

Në rastin e ndonjë vonese në shlyerjen e pagesës së kërkuar sipas nenit 2, norma e interesit e përcaktuar në nenin 3 të kësaj Marrëveshjeje do të rritet me një për qind pikë nga data e caktuar e kështit të shlyerjes deri në ditën në të cilën merret pagesa. Kjo rritje nuk zbatohet nëse vonesa në pagesë është më pak se pesëmbëdhjetë ditë.

Neni 5

Pagesa do të kryhet në numrin e llogarisë, me....., me.....përkatës.

Neni 6

Kjo Marrëveshje nuk ndryshohet pa pëlqimin me shkrim të të dy Palëve.

Neni 7

Para nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje, shoqëritë zvicerane duhet të paraqesin aprovimin e tyre për këtë Marrëveshje, me shkrim, nëpërmjet Ambasadës Zvicerane në Tiranë.

Neni 8

Njoftimet që bëhen në pajtim me këtë Marrëveshje, dërgohen në adresat si më poshtë:

Ministria e Financave
Departamenti i Përgjithshëm i Thesarit
Bulevardi: Dëshmorët e Kombit, Tiranë, Shqipëri

Tel: ++3554228405

Fax: ++3554228494

Pala zvicerane
Edmond Kërliu
Av.Jomini 8
CH 1004 Lausanne
Tel: + 41 21 641 6734
Fax: +41 21 641 6735

Neni 9

Hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi pas përfundimit të procedurave të nevojshme ligjore që kërkohen nga legjislacioni shqiptar dhe mbetet në fuqi derisa Palët të përmbushin detyrimet e tyre të parashikuara prej saj.

Bërë në Tiranë, më2008, në dy kopje origjinale në gjuhën angleze.

LIGJ
Nr.9961, datë 21.7.2008

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES SË HUASË NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM (IBRD) PËR FINANCIMIN E PROJEKTIT “PËRBALLIMI DHE ZBUTJA E RREZIKUT NGA FATKEQËSITË””

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja e huasë ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD) për financimin e projektit “Përballimi dhe zbutja e rrezikut nga fatkeqësitë””.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5839, datë 29.7.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

MARRËVESHJE E HUASË
(PROJEKTI PËR PËRBALLIMIN DHE ZBUTJEN E RREZIKUT NGA KATASTROFAT)
MIDIS SHQIPËRISË DHE BANKËS NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM

Marrëveshje e datës _____, 200_, midis Shqipërisë (Huamarrësit) dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (Bankës).

Duke pasur parasysh faktin që: (A) Banka ka marrë një letër të politikave të zhvillimit më datën ____maj 2008 nga Huamarrësi ku përshkruhet programi i veprimeve, objektivat dhe politikat (Programi), i cili synon të forcojë kapacitetet kombëtare në përgatitjen dhe përgjigjen ndaj katastrofave dhe ku deklarohet angazhimi i Huamarrësit për zbatimin e këtij programi;

B. Huamarrësi ka kërkuar mbështetjen e Bankës në zbatimin e programit nëpërmjet një seri huash¹ për një periudhë afërsisht 8-vjeçare, e cila do të përdoret nga Huamarrësi në zbatimin e programit;

C. Huamarrësi mbetet i kënaqur me realizueshmërinë dhe prioritetin e fazës së parë të programit (projekti) të përshkruar në listën 1 bashkëngjitur kësaj Marrëveshjeje, i ka kërkuar Bankës të asistojë në financimin e këtij projekti;

D. Huamarrësi i ka kërkuar Shoqatës të sigurojë asistencë plotësuese në financimin e projektit

¹ Aktivitetet pasuese për fazën e dytë do të paraqiten në shtojcën bashkëngjitur letrës suplementare të Marrëveshjes së huasë.

dhe me anë të një Marrëveshjeje të së njëjtës datë midis Huamarrësit dhe Shoqatës (Marrëveshje financiare), Shoqata bie dakord të sigurojë një asistencë të tillë në një shumë totale prej tre milionë e tetëqind mijë, Special Drawing Rights (Të drejta tërheqjeje të veçanta) (SDR 3 800 000) (Kredi); dhe Huamarrësi dhe Banka nëpërmjet kësaj bien dakord që:

Neni 1

Kushtet e përgjithshme, përkufizimet

1.01 Kushtet e përgjithshme (siç përcaktohen në shtojcën e kësaj Marrëveshjeje) konsiderohen pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshjeje.

1.02 Nëse konteksti e kërkon ndryshe nga sa këtu, termat me shkronja kapitale të përdorura në këtë Marrëveshje kanë kuptimet që u janë caktuar atyre në kushtet e përgjithshme, si dhe në shtojcën e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 2

Huaja

2.01 Banka bie dakord t'i japë Huamarrësit, sipas afateve dhe kushteve të paraqitura ose të përmendura në këtë Marrëveshje, një hua në shumën prej 2 milionë eurosh (EUR 2 000 000), meqenëse kjo shumë mund të konvertohet herë pas here sipas tabelës së konvertimit të monedhës në përputhje me dispozitat e seksionit 2.07 të kësaj Marrëveshjeje (Hua), për të ndihmuar në financimin e pjesëve 1.2 dhe 4 të projektit.

2.02 Huamarrësi mund ta tërheqë shumën e huasë, në përputhje me seksionin IV të listës 2 të kësaj Marrëveshjeje.

2.03 Shuma direkte e paguar nga Huamarrësi do të jetë e barabartë me një të tretën e një për qindshit (0.25 %) të shumës së Huasë. Huamarrësi do ta paguajë shumën direkte jo më vonë se gjashtëdhjetë (60) ditë nga data e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

2.04 Interesi i paguar nga Huamarrësi për çdo periudhë interesi do të jetë në një normë të barabartë me LIBOR për monedhën e huasë plus monedhën variabël; me kusht që, në momentin e konvertimit të një pjese apo të gjithë shumës totale të huasë, interesi që do të paguhet nga Huamarrësi gjatë periudhës së konvertimit për një shumë të tillë të përcaktohet në përputhje me dispozitat respektive të nenit IV të kushteve të përgjithshme. Pavarësisht për sa më lart, nëse ndonjë shumë nga shuma e tërhequr e huasë) mbetet e papaguar përkarshi afatit të bërjes së pagesës dhe nëse moskryerja e pagesës vazhdon për një periudhë tridhjetëditore, atëherë interesi që do të paguhet nga Huamarrësi që do të përllogaritet ashtu siç parashtrohet në seksionin 3.02 (d) të kushteve të përgjithshme.

2.05 Datat e pagesës janë 15 marsi dhe 15 shtatori për secilin vit.

2.06 Shuma kryesore e huasë do të ripaguhet në përputhje me tabelën e amortizimit të paraqitur në listën 3 bashkëlidhur me këtë Marrëveshje.

2.07 a) Huamarrësi mund të kërkojë në çdo kohë njërën nga format e mëposhtme të konvertimit të kushteve të huasë me synim që të lehtësojë një menaxhim sa më efektiv të borxhit: i) një ndryshim i monedhës së huasë për një pjesë apo të gjithë shumës totale të huasë, të tërhequr apo të patërhequr, në një monedhë të aprovuar; dhe ii) një ndryshim të bazës së normës së interesit që mund t'i aplikohet një pjese apo të gjithë shumës së huasë të tërhequr dhe të prapambetur nga një normë variabël në një normë fikse ose anasjellas.

b) Çdo konvertim që kërkohet sipas paragrafit (a) të këtij seksioni dhe që është i pranueshëm për Bankën do të konsiderohet "Konvertim", siç përcaktohet në kushtet e përgjithshme, dhe do të hyjë në fuqi në përputhje me dispozitat e nenit IV të kushteve të përgjithshme dhe të udhëzimeve të konvertimit.

Neni 3

Projekti

3.01 Huamarrësi deklaron angazhimin e tij në arritje të objektivave të projektit dhe të programit. Për këtë qëllim, Huamarrësi do të: i) realizojë: A) pjesët 1 dhe 5 të projektit me anë të MB-së; B) pjesa 3 e projektit do të realizohet nga MPBTT; dhe C) pjesa 4 e projektit do të realizohet nga

MF; dhe ii) të bëjë që pjesa 2 e projektit të realizohet nga IEUM, të gjitha në përputhje me dispozitat e nenit IV të kushteve të përgjithshme.

3.02 Pa vendosur kufizime ndaj dispozitave të seksionit 3.01 të kësaj Marrëveshjeje, përjashtuar rastet kur Huamarrësi dhe Banka bien dakord ndryshe, Huamarrësi duhet të sigurojë që projekti të realizohet në përputhje me dispozitat e listës 2 bashkëlidhur kësaj Marrëveshjeje.

3.03 Pa vendosur kufizime ndaj dispozitave të seksionit 3.01 të kësaj Marrëveshjeje, dhe me përjashtim të rasteve kur Huamarrësi dhe Banka bien dakord ndryshe, Huamarrësi duhet të sigurojë që projekti realizohet në përputhje me dispozitat e listës 2 bashkëlidhur kësaj Marrëveshjeje.

Neni 4

Mjetet ndreqëse nga banka

4.01 Ngjarje ose situata të tjera që çojnë në pezullim konsistojnë si më poshtë:

a) Një situatë ka lindur, e cila e ka bërë të pamundur implementimin e një pjese të projektit apo një pjese të qenësishme të tij.

b) Kur ndonjë dispozitë e vendimeve në rast emergjencash është amenduar, pezulluar përkohësisht, shfuqizuar apo anuluar, ose kur ndonjë ligj, dekret apo legjislacion ose instrument i njëjtë është adoptuar, i cili prek materialisht dhe në mënyrë të pafavorshme biznesin, veprimet dhe aktivitetet e kompanisë së sigurimeve ndaj risqeve katastrofike në Europën Juglindore.

Neni 5

Efektiviteti, përfundimi

5.01 Kushtet e tjera të efektivitetit përbëhen si më poshtë:

a) Marrëveshja financiare është realizuar dhe zbatuar dhe të gjitha kushtet që paraprijnë efektivitetin e saj, me përjashtim të kushteve që lidhen me efektivitetin e kësaj Marrëveshjeje, janë plotësuar si të tilla; dhe

b) Procesi i regjistrimit të CRIF është ndërmarrë në një formë dhe përmbajtje të pranueshme nga Banka dhe se masat përgatitore, që janë të pranueshme nga Banka, janë realizuar me një kompani menaxhuese, të pranueshme po nga Banka, e cila do të menaxhojë CRIF.

5.03 Afati i hyrjes në fuqi është njëqind e tetëdhjetë (180) ditë pas datës së nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 6

Përfaqësuesi, adresat

6.01 Përfaqësuesi i Huamarrësit është Ministri i Financave

6.02 Adresa e Huamarrësit është:

Ministria e Financave

Bulevardi: Dëshmorët e Kombit, nr. 1

Tiranë,

Shqipëri

Faksimil:

(355)-42-228494

6.03 Adresa e Bankës është:

Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim

1818 H Street, N.W.

Washington, D.C. 20433

Shtetet e Bashkuara të Amerikës

Adresa postare:

Teleks:

Faksimil:

INTBAFRAD

248423(MCI) or

(1)-202-477-6391

Washington, D.C.

64145(MCI)

6.04 Nëse Huamarrësi nuk është informuar ndryshe nga Banka:

a) Të gjitha veprimet e marra, përfshirë miratimet e dhëna nga Shoqata sipas: i) seksioneve 2.02 dhe 3.02 të Marrëveshjes financiare; dhe ii) listat 1 dhe 2 të Marrëveshjes financiare, përveç

seksionit IV të listës 2, presupozohen të jenë marrë në emër dhe në interes të Shoqatës dhe të Bankës; dhe

b) I gjithë informacioni dhe dokumentacioni i siguruar nga Huamarrësi për Shoqatën sipas dispozitave të seksioneve dhe të listave të Marrëveshjes financiare të renditura në paragrafin (a) të këtij seksioni do të konsiderohen të dhëna si për Shoqatën, ashtu edhe për Bankën

Nënshkruar në _____, _____, në përputhje me datën dhe vitin e shkruar më lart midis

SHQIPËRISE

Nga
Përfaqësuesi i autorizuar

BANKËS NDËRKOMBËTARE PËR
RINDËRTIM DHE ZHVILLIM

Nga
Përfaqësuesi i autorizuar

LISTA 1 PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

Objektivi i projektit është forcimi i kapaciteteve institucionale: a) reduktimi i pikave të dobëta të përfituesit të huasë ndaj katastrofave natyrore apo atyre të shkaktuara nga aktivitetet e njeriut; dhe b) kufizimi i humbjeve njerëzore, ekonomike dhe financiare ndaj këtyre katastrofave.

Projekti përbën fazën e parë të programit dhe përbëhet nga pjesët e mëposhtme:

Pjesa 1: Gatishmëria ndaj dhe menaxhimi i riskut të katastrofave

Realizimi i një programi në mbështetje të krijimit të kapaciteteve në përgjigje të situatave emergjente nëpërmjet sigurimit të pajisjeve të nevojshme dhe forcimit të planifikimit për zbutjen e riskut të katastrofave, duke përfshirë në mënyrë specifike të mëposhtmet:

1. Forcimi i planifikimit të zbutjes së riskut të katastrofave dhe menaxhimi i situatave të jashtëzakonshme

a) Realizimi i rishikimit dhe përditësimit të kuadrit ligjor të vendit lidhur me reagimin ndaj situatave të jashtëzakonshme, duke përfshirë edhe rishikimet e ligjit të vitit 2001 mbi shërbimet e emergjencave civile, rishikimin e draftlegjislacionit, hartimin e kuadrit themelor rregullator dhe propagandimin e ligjit të ri të propozuar te partnerët e duhur;

b) Zhvillimin e një strategjie kombëtare për menaxhimin e riskut të katastrofave dhe programin e investimeve me synim formulimin e një pakete prioritare të investimeve kryesore në zbutjen dhe përballimin e situatave të jashtëzakonshme;

c) Përgatitjen dhe implementimin e ndërgjegjësimit publik dhe fushatave arsimore që përfshijnë: i) rritjen e ndërgjegjësimit publik nëpërmjet hartimit të kurrikulave shkollore lidhur me përgatitjen në rast katastrofash, botimin e materialeve arsimore dhe trajnimin e mësuesve në zbatim të kësaj kurrikule; dhe ii) hartimin e strategjive multimediatike të komunikimit publik duke përdorur, mes të tjerash, radion, televizorin dhe internetin.

2. Forcimi i kapacitetit të reagimit ndaj situatave të jashtëzakonshme

a) Realizimi i një vlerësimi formal të nevojave për pajisje që përdoren në rast situatash të jashtëzakonshme dhe, në bazë të tyre, sigurimi i pajisjeve për grupet e kërkim-shpëtimit në zonat urbane, operacionet e shpëtimit në rast përmytjesh ose në rast të bllokimit të zonave malore nga dëbora, si dhe pajisje të mbrojtjes personale dhe krijimi i një qendre të lëvizshme operacionale;

b) Forcimi i qendrave ekzistuese të operacioneve në rast situatash të jashtëzakonshme, përfshirë sigurimin me pajisje të qendrës kombëtare të operacioneve dhe asistencë teknike për krijimin e tri qendrave operacionale rajonale përfshirë vlerësimet e nevojshme të impaktit në mjedis dhe të atyre në jetën e njerëzve;

c) Realizimin e studimeve të fisibilitetit dhe projekteve për krijimin e një sistemi të integruar të thirrjeve telefonike në rast katastrofash “112” dhe të një sistemi të komunikimit në rast emergjencash, veçanërisht krijimin e një sistemi të komunikimit me radio;

d) Hartimin e procedurave të detajuara që ndiqen në përgjigje të situatave të jashtëzakonshme për të bërë të mundur ndërhyrjet e shpeshta dhe të efektshme në rast ngjarjesh me përmasa katastrofike;

e) Sigurimi i trajnimit të specializuar për personat që reagojnë të parët ndaj situatave të

jashtëzakonshme, si dhe sigurimi i rekomandimeve për reagime të duhura përfshirë aktivitete ushtrimore për mbrojtjen civile, skuadrat zjarrfikëse dhe personelin mjekësor.

Pjesa 2: Forcimi i shërbimeve hidrometeorologjike

Realizimi i një programi në mbështetje të reduktimit të riskut ndaj katastrofave përmes sigurimit të parashikimeve dhe shërbimeve të sakta hidrometeorologjike që u përgjigjen më mirë nevojave të drejtuesve të risqeve katastrofike në sektorin e parashikimit të motit që përfshijnë:

1. Forcimi i aksesit ndaj të dhënave

Krijimi i lidhjeve të telekomunikacionit dhe shërbimeve kompjuterike në Institutin e Mjedisit, Ujërave dhe Energjisë, të cilat duhet të jenë të përshtatshme për komunikim në kohë reale me stacionet në terren, modelim të modernizuar dhe me rezolutë më të lartë të shërbimeve meteorologjike, si dhe menaxhimin e ndarjen e një volumi të madh të dhënash mbi motin dhe klimën, si brenda territorit të Huamarrësit, ashtu dhe me partnerët e tjerë të Organizatës Botërore Meteorologjike. Kjo qendër do të përbëhet nga instalimi i një rrjeti të shëndoshë interneti (brenda rrjetit) i aftë për të mbështetur funksionet parashikuese të IEUM-së, krijimin, lidhjen në rrjet, menaxhimin e të dhënave, krijimin e serverëve të aplikimit, stacionet për stafin, furnizim pa ndërprerje me energji elektrike, përmirësim në lidhjet e telekomunikacionit nga stacionet në terren me stacionin qendror, pajisje për menaxhimin e të dhënave përfshirë instalimin e skanerit, softuerëve dhe stacioneve për arkivimin e të dhënave të mëparshme, si dhe kontrollin cilësor e arkivimin e të dhënave aktuale dhe krijimin e një rrjeti Web dinamik për të paraqitur dhe ndarë të dhënat dhe parashikimet atmosferike.

2. Përmirësimi i rrjetit të monitorimit dhe parashikimit të motit

Forcimi i rrjetit të monitorimit të sipërfaqes përfshirë atë tek IEUM, MM, si dhe tek Agjencia e Trafikut Ajror për të rinovuar stacionet meteorologjike ekzistuese dhe për të siguruar stacione meteorologjike dhe hidrologjike monitorimi, si dhe stacione të specializuara apo stacione ultratingull në shtresat sipërfaqësore të ajrit, si dhe një stacion satelitor me lidhje poshtë për të mundësuar një përdorim sa më produktiv të të dhënave satelitore për qëllime të ndryshme.

3. Krijimi i kapacitetit për të përgatitur produkte parashikimi për menaxhimin e katastrofave

Forcimi i kapaciteteve parashikuese të motit pranë IEUM-së me synim përgatitjen e produkteve bazë më të sakta të parashikimit në sinkroni me menaxhimin e katastrofave nëpërmjet sigurimit të softuerëve, trajnimit dhe kompjuterizimit e burimeve të nevojshme për të ndërmarrë një model të motit në një zonë lokale në vend dhe në bazë të saj për të forcuar shërbime si informimin në kohë për dukuri atmosferike të pafavorshme me rezolutë më të lartë dhe kohë fillimi dhe përfundimi të dukurisë atmosferike në lidhje me kushtet e përmbytjeve dhe mbulimin me shtresë dëbore bazuar në parashikimin e reshjeve të shiut, paralajmërime për zjarre të shkaktuara nga moti, njoftime lidhur me kushtet e rrugës nën efektin e motit dhe njoftime për ngrica/thatësira për bujqësinë.

Pjesa 3: Krijimi i kodeve të ndërtesave

Realizimi i një programi për të reduktuar risqet nga katastrofat nëpërmjet hartimit të kodeve të përmirësuara dhe krijimit të mekanizmave për futjen e standardeve të përmirësuara duke përfshirë:

1. Hartimin e një kodi kombëtar të ndërtesave

Realizimi i një rishikimi të legjislacionit të kodeve të ndërtesave, i cili aktualisht është në shqyrtim e sipër, ku fokusi vihet te kriteret e aplikueshme të projektimit ndaj tërmeteve, përfshirë asistencë për adoptimin e kodeve të Bashkimit Europian në vend.

2. Trajnimi ndaj inxhinierëve në standardet e reja të projektimit

Hartimi i materialeve të trajnimit për të trajnuar inxhinierë në kodet e reja të rishikuara të ndërtimit dhe trajnimi i mësuesve.

3. Zhvillimi i një mekanizmi për licencimin e inxhinierëve

Zhvillimi i një sistemi për të certifikuar, licencuar dhe rishikuar licencat për inxhinierët e projektimit dhe të supervizionit.

Pjesa 4: Kompania e sigurimeve të katastrofave në Europën Juglindore

1. Sigurimi i anëtarësimit të përfituesit në CRIF

Sigurimi i financimit për pagesën e anëtarësimit dhe pjesëmarrjes së Huamarrësit në CRIF me synim sigurimin e aksesit ndaj produkteve financiarisht të përballueshme dhe të besueshme të sigurimeve ndaj katastrofave, të cilat reduktojnë ekspozimin fiskal të Huamarrësit ndaj fatkeqësive natyrore.

2. Vendosja e pranisë së CRIF në tregun e sigurimeve në Shqipëri

Realizimi i një programi, i cili synon të lehtësojë adoptimin e një kornize politikash nga ana e

Huamarrësit, i aftë për të favorizuar funksionimin e CRIF në territorin e vet që përfshin miratimin dhe implementimin e ligjeve dhe rregulloreve në favor të funksionimit të CRIF dhe që lehtëson investimet në arsimin publik dhe ndërgjegjësimin e publikut për dobittë që sjell siguri ndaj katastrofave.

Pjesa 5: Menaxhimi i projektit

Sigurimi i mbështetjes në menaxhimin e projektit nëpërmjet financimit të kostove të përzgjedhura të menaxhimit, përfshirë shërbimet e konsulentëve, shërbimet për prokurimet dhe menaxhimin financiar, si dhe monitorimin dhe vlerësimin.

LISTA 2 EKZEKUTIMI I PROJEKTIT

Seksioni I. Masat për implementimin e projektit

A. Përgatitja institucionale

1. Ministria e Brendshme

Huamarrësi, nëpërmjet Ministrisë së Brendshme, do të jetë përgjegjës për Implementimin e projektit si institucioni kryesor përgjegjës për menaxhimin e katastrofave.

2. Komiteti Drejtues i projektit

Huamarrësi, nëpërmjet Ministrisë së Brendshme, do të krijojë dhe mbështesë, përmes implementimit të projektit, jo më vonë se data 1 nëntor 2008 një Komitet Drejtues të Implementimit (KDZ) të projektit, sipas termave të referencës dhe burimeve të pranueshme nga Banka. Komiteti Drejtues i Implementimit të projektit do të jetë përgjegjës për sigurimin e koordinimit midis sektorëve të ndryshëm, duke monitoruar progresin në implementimin e projektit dhe duke zgjidhur probleme që lidhen me politikat lidhur me menaxhimin e riskut të katastrofave, si dhe probleme që lidhen me vonesa në implementimin e projektit. KDZ do të kryesohet nga zëvendësministri i brendshëm. Në përbërje të tij do të ketë përfaqësues nga Drejtoria e Përgjithshme e Emergjencave Civile të Ministrisë së Brendshme, Drejtori i Institutit të Energjisë, Ujërave dhe Mjedisit, Shefi i Shërbimit të Parashikimit të Motit të Komandës së Forcave Ajrore, Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Trafikut Ajror, Ministria e Financave dhe Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Drejtoria e Përgjithshme e Emergjencave Civile, që shërben si sekretariati i projektit dhe Drejtoria e Strategjisë dhe Koordinimit të Donatorëve pranë Këshillit të Ministrave në rolin e vëzhguesit.

3. Grupi i menaxhimit të projektit

Huamarrësi, përmes Ministrisë së Brendshme, do të krijojë dhe mbështesë gjatë implementimit të projektit një grup të menaxhimit të projektit (GMP) sipas termave të referencës dhe me burime të mjaftueshme të pranueshme nga ana e Bankës. Grupi i sipërpërmendur do të përgjigjet për menaxhimin e projektit pranë Ministrisë së Brendshme, si dhe për prokurimet, menaxhimin financiar dhe monitorimin e projektit në tërësi. Në përbërjen e grupit bëjnë pjesë stafi i emëruar nga vet Drejtoria e Përgjithshme e Emergjencave Civile, ekspertë të kontraktuar për menaxhimin financiar dhe menaxhimin e prokurimeve, si dhe një koordinator i grupit të implementimit nga IEUM, MPPTT dhe MF respektivisht, për të koordinuar aktivitetet e agjencisë me grupin e menaxhimit të projektit.

4. Grupi (grupet) e implementimit

Huamarrësi, nëpërmjet Ministrisë së Brendshme, do të krijojë dhe mbështesë, përmes implementimit të projektit, jo më vonë se data 1 nëntor 2008 një grup zbatues brenda IEUM-së, MPPTT-së dhe Ministrisë së Financave sipas termave të referencës dhe me burime të pranueshme nga Banka. Secili grup zbatues do të jetë përgjegjës për të kontribuar ndaj elementeve kryesorë të implementimit të pjesës respektive të projektit, duke formuluar termat e referencës për aktivitetet respektive, duke marrë pjesë në komisionet e vlerësimit dhe miratimit të kontratave për firmë nga zyrtari i autorizuar i projektit. Çdo grup implementimi do të kryesohet nga koordinatori i grupit të implementimit dhe do të përfshijë specialistë sektori

4. Grupi i punës për strategjinë e zbutjes së riskut ndaj katastrofave

Huamarrësi, nëpërmjet Ministrisë së Brendshme, do të krijojë dhe mbështesë, përmes implementimit të projektit, jo më vonë se data 1 tetor 2008 një grup pune për strategjinë e zbutjes së riskut të katastrofave sipas termave të referencave të pranueshme nga Banka dhe që përfshin përfaqësues nga të gjitha ministrinë që merren me zbutjen e riskut të katastrofave. Ky grup pune do të ketë përgjegjësinë që të përgatisë strategjinë kombëtare të zbutjes dhe përballimit të riskut të katastrofave të përmendur në paragrafin 3 të pjesës B të seksionit 1.

5. Grupi i punës i sigurimit të katastrofave

Me synim përbushjen e obligimeve që rrjedhin nga anëtarësimi në CRIF, jo më vonë se tridhjetë (30) ditë pas krijimit të CRIF, Huamarrësi do të formojë një grup pune për sigurimin ndaj katastrofave në përbërje të të cilit do të ketë përfaqësues të MF, të Autoritetit Mbikëqyrës të Institucioneve Financiare Jobankare dhe agjenci të tjera qeveritare dhe/ose institucione të tjera të përshtatshme. Grupi do të drejtohet nga kryetari i përzgjedhur nga MF, i cili përfaqëson edhe Huamarrësin në Bordin e Guvernatorëve të CRIF.

B. Modalitetet e implementimit

I. Marrëveshje implementimi

1. Pjesa 4.1 e projektit: Marrëveshja bilaterale për shpërndarjen e produktit lokal

Huamarrësi, përmes MF-së, do të lidhë jo më vonë se gjashtë (6) muaj pas datës së hyrjes në fuqi, një marrëveshje bilaterale me CRIF sipas afateve dhe kushteve të pranueshme nga Banka, e cila do të aftësojë CRIF t'i shpërndajë shërbimet e veta përmes kompanive të sigurimeve lokale sipas legjislacionit të Komisionit Shqiptar të Sigurimeve.

2. Strategjia për përballimin dhe zbutjen e riskut të katastrofave

Huamarrësi, përmes MB-së, do të përgatisë, jo më vonë se 31 janari 2010 një draft strategji të përballjes dhe zbutjes së riskut të katastrofave, e pranueshme nga Banka, e cila do t'i japë prioritet në mënyrë të duhur veprimeve dhe investimeve në zbutjen e riskut të katastrofave.

C. Masa kundër korrupsionit

Huamarrësi do të sigurojë që projekti të realizohet në përputhje me dispozitat e udhëzimeve kundër korrupsionit.

Seksioni II. Monitorimi, raportimi dhe vlerësimi i projektit

A. Raportet e projektit

1. Huamarrësi përmes MB-së do të monitorojë dhe vlerësojë progresin e projektit dhe do të përgatisë raportet e projektit në përputhje me dispozitat e seksionit 5.08 të kushteve të përgjithshme dhe në bazë të indikatorëve të monitorimit dhe vlerësimit. Çdo raport projekti do të mbulojë një semestër kalendarik, dhe do t'i paraqitet Bankës jo më vonë se një (1) muaj pas përfundimit të periudhës së mbuluar nga një raport i tillë.

2. Duke u nisur nga seksioni 5.08 i kushteve të përgjithshme, raporti mbi ekzekutimin e projektit dhe planin e lidhur me të i kërkuar sipas atij seksioni do t'i paraqitet Bankës jo më vonë se data 30 gusht 2012.

B. Menaxhimi financiar, raportet financiare dhe kontrolli financiar/auditimet

1. Huamarrësi, përmes MB-së do të mbajë në funksionim një sistem të menaxhimit financiar në përputhje me dispozitat e seksionit 5.09 të kushteve të përgjithshme.

2. Pa vendosur ndonjë kufizim ndaj dispozitave të pjesës A të këtij seksioni, Huamarrësi, përmes MB-së do të përgatisë dhe do t'i paraqesë Bankës si pjesë e Raportit të Projektit jo më vonë se dyzetë e pesë ditë (45) pas përfundimit të çdo tremujori kalendarik raporte të përkohshme financiare për projektin që mbulon tre-mujorin në formën dhe përmbajtjen e pranueshme nga Banka.

3. Huamarrësi, përmes MB-së, do të auditojë deklaratat financiare në përputhje me dispozitat e seksionit 5.09 (b) të kushteve të përgjithshme. Çdo auditim i deklaratave financiare do të mbulojë një periudhë të një viti fiskal të Huamarrësit. Deklaratat financiare të audituara për secilën periudhë do t'i paraqiten Bankës jo më vonë se 6 muaj pas përfundimit të secilës periudhë.

C. Raporti afatmesëm

Huamarrësi përmes MB-së:

a) do të mbajë në funksion politikat dhe procedurat e mjaftueshme për të aftësuar atë që të monitorojë dhe vlerësojë vazhdimisht në përputhje me indikatorët e monitorimit dhe vlerësimit realizimin e projektit dhe arritjen e objektivave;

b) do të përgatisë dhe do t'i paraqesë Bankës, sipas termave të referencës të pranueshme nga Banka, jo më vonë se 31 dhjetori 2009 një raport, i cili integron rezultatet e aktiviteteve të monitorimit dhe vlerësimit të kryera sipas paragrafit (a) të këtij seksioni, mbi progresin e shënuar; ii) aktivitetet e kryera në realizimin e projektit gjatë fazës që paraprin datën e raportit në fjalë; dhe iii) mbi realizimin e veprimeve të përmendura në programin dhe në arritjen e indikatorëve kryesorë me synim fillimin dhe realizimin e fazës së dytë të programit, si dhe vendosja e masave të rekomanduara për të siguruar një realizim efikas të projektit dhe arritjen e objektivave gjatë periudhës që vijon një datë të tillë; dhe

c) do të rishikojë me Bankën, më ose rreth datës 31 janar 2010, ose në një datë të më vonshme, siç e kërkojnë procedurat e Bankës, raportin e përmendur në paragrafin (b) të këtij seksioni, dhe, pas kësaj, të marrë të gjitha masat e kërkuara për të siguruar një realizim efikas të projektit dhe arritje të objektivave, bazuar në konkluzionet dhe rekomandimet e raportit në fjalë dhe sipas mendimeve të Bankës për çështjen në fjalë.

Seksioni III. Prokurimet

A. Të përgjithshme

1. Të mirat dhe shërbimet (pa përfshirë shërbimet e konsulentëve). Të gjitha të mirat dhe shërbimet (jo shërbimet e konsulentëve) të kërkuara për projektin dhe që do të financohen nga shuma e financimit do të prokurohen në përputhje me kriteret e vendosura ose të përmendura në seksionin I të udhëzimeve të prokurimeve dhe në përputhje me dispozitat e këtij seksioni.

2. Shërbimet e konsulentëve. Të gjitha shërbimet e konsulentëve të kërkuara për projektin dhe që do të financohen nga shuma e financimit do të prokurohen në përputhje me kriteret e vendosura ose të përmendura në seksionet I dhe IV të udhëzimeve të konsulentit dhe në përputhje me dispozitat e këtij seksioni.

3. Përkufizimet. Termat me shkronja kapitale të përdorura më poshtë në këtë seksion për të përshkruar metodat e veçanta të prokurimit ose metodat e shqyrtimit nga ana e Bankës të kontratave të veçanta të përmendura në metodën përkatëse të përshkruara në udhëzimet e prokurimit ose udhëzimet e konsulentit sipas rastit.

B. Metodat e veçanta të prokurimit të të mirave dhe shërbimeve (jo shërbimet e konsulentit).

1. Tenderi ndërkombëtar konkurrues: Përveç rasteve të dhëna në paragrafin 2 më poshtë, të mirat dhe shërbimet (pa përfshirë shërbimet e konsulentëve) do të prokurohen sipas kontratave të lidhura në bazë të tenderit ndërkombëtar konkurrues.

2. Metoda të tjera të prokurimit të të mirave dhe shërbimeve (jo shërbimet e konsulentit). Tabela vijuese specifikon metodat e prokurimit, jo tenderin ndërkombëtar konkurrues, të cilat mund të përdoren për të mirat dhe shërbimet (jo shërbimet e konsulentëve). Plani i prokurimit do të specifikojë kushtet nën të cilat do të përdoren këto metoda:

Metoda e prokurimit
a) Blerja
b) Kontraktimi direkt

C. Metodat e veçanta të prokurimit të shërbimit të konsulentëve.

1. Përzgjedhja në bazë të cilësisë dhe koston. Përveç rastit të përmendur në paragrafin 2 më poshtë, shërbimet e konsulentëve do të prokurohen sipas kontratave të lidhura në bazë të përzgjedhjes cilësore apo me bazë kostoje.

2. Metoda të tjera të prokurimit të shërbimit të konsulentëve. Tabela që vijon specifikon metodat e prokurimit, jo përzgjedhjen me bazë cilësie dhe kostoje, të cilat mund të përdoren për shërbimet e konsulentëve. Plani i prokurimit do të specifikojë rrethanat sipas të cilit do të përdoren këto metoda.

Metoda e prokurimit
a) Përzgjedhje e bazuar në kualifikimin e konsulentëve
b) Përzgjedhje sipas një buxheti fiks
c) Përzgjedhje me koston më të vogël
d) Përzgjedhje nga një burim i vetëm
e) Përzgjedhje e konsulentëve individualë

D. Rishqyrtimi nga Banka i vendimeve të prokurimit

Plani i prokurimit do të përcaktojë këto kontrata, të cilat do t'i nënshtrohen rishqyrtimit paraprak nga Banka. Të gjitha kontratat e tjera do t'i nënshtrohen rishqyrtimit të mëpasshëm nga Banka.

Seksioni IV. Tërheqja e shumës së financimit

A. Të përgjithshme

1. Huamarrësi mund të tërheqë shumën e financimit në përputhje me dispozitat e nenit II të kushteve të përgjithshme, të këtij seksioni, dhe sipas udhëzimeve shtesë të specifikuara më anë të

njoftimit për Huamarrësin nga Banka (përfshirë “Udhëzimet e disbursimit të Bankës Botërore për projektet” e muajit maj 2006, e rishikuar herë pas here nga Banka dhe që i aplikohet kësaj Marrëveshjeje në vijim të këtyre udhëzimeve) për të financuar shpenzimet e pranueshme, siç paraqiten në tabelën e paragrafit 2 më poshtë.

2. Tabela e mëposhtme specifikon kategoritë e shpenzimeve të duhura që mund të financohen nga shuma e financimit (Kategoritë), alokimet e shumës së kredisë për secilën kategori, si dhe përqindjen e shpenzimeve që do të financohet për shpenzimet e duhura në secilën kategori.

Kategoria	Sasia e kredisë së alokuar (e shprehur në euro)	Përqindja e shpenzimeve që do të financohet
1. Të mirat sipas pjesës 1.2 të projektit	270 000	80 %
3. Kontributi i anëtarësimit sipas pjesës 4.1 të projektit	1 330 000	100 %
2. Shërbimet e konsulentëve sipas pjesës 4.2 të projektit	400 000	80%
Shuma në total	2 000 000	

Për qëllime të specifikuara në këtë seksion, termi “Kontribut anëtarësimi” do të thotë shpenzimet e bëra nga Huamarrësit për të siguruar anëtarësimin dhe pjesëmarrjen e vet në CRIF.

B. Kushtet e tërheqjes. Periudha e tërheqjes

1. Pavarësisht dispozitave të pjesës A të këtij seksioni, asnjë tërheqje nuk do të bëhet për pagesa të bëra para datës së kësaj Marrëveshjeje .

2. Data e mbylljes është data 28 shkurt 2012.

LISTA 3 TABELA E AMORTIZIMIT

1. Tabela që vijon paraqet data e pagesës kryesore të huasë dhe përqindjen e sasisë totale të huasë të pagueshme për secilën datë të pagesës kryesore (Pjesa e kështit/instalimit”). Nëse shumat e huasë janë tërhequr plotësisht qysh më datën e pagesës kryesore, atëherë sasia kryesore e huasë e pagueshme nga Huamarrësi në çdo datë pagese kryesore do të përcaktohet nga Banka duke shumëzuar: i) bilancin e tërhequr të huasë qysh më datën e pagesës kryesore; me ii) pjesën e kështit për secilën datë të pagesës kryesore; sasi e tillë e ripagueshme mund të përshtatet, sipas rastit, për të zbritur çdo sasi të përmendur në paragrafin 4 të këtij seksioni, ndaj të cilët aplikohet kursi i konvertimit të monedhës).

Datat e pagesës kryesore	Pjesa e kështit (Shprehur si përqindje)
15 mars 2019	2.57 %
15 shtator 2019	2.66 %
15 mars 2020	2.75 %
15 shtator 2020	2.85 %
15 mars 2021	2.95 %
15 shtator 2021	3.05 %
15 mars 2022	3.16 %
15 shtator 2022	3.27 %
15 mars 2023	3.38 %
15 shtator 2023	3.50 %
15 mars 2024	3.62 %
15 shtator 2024	3.75 %
15 mars 2025	3.88 %
15 shtator 2025	4.02 %
15 mars 2026	4.16 %

15 shtator 2026	4.30 %
15 mars 2027	4.46 %
15 shtator 2027	4.61 %
15 mars 2028	4.77 %
15 shtator 2028	4.94 %
15 mars 2029	5.11 %
15 shtator 2029	5.29 %
15 mars 2030	5.48 %
15 shtator 2030	5.67 %
15 mars 2031	5.80 %

2. Në qoftë se shumt e huasë nuk janë tërhequr plotësisht qysh më datën kryesore të pagesës, sasia kryesore e huasë e ripagueshme nga Huamarrësi më secilën datë kryesore të pagesës do të përcaktohet si më poshtë vijon:

a) Në atë nivel që çdo shumë e huasë është tërhequr qysh nga data e pagesës kryesore, Huamarrësi do të ripagujë shumën e tërhequr të huasë në një datë të tillë në përputhje me paragrafin 1 të këtij programi.

b) Çdo shumë e tërhequr pas datës së pagesës kryesore do të ripaguhet më secilën datë kryesore të pagesës që bie fill pas datës së një tërheqjeje të tillë në shumt e përcaktuara nga Banka duke shumëzuar sasinë e secilës tërheqje me thyesën, numërori i së cilës është pjesë e kështit fillestar të specifikuar në tabelën në paragrafin 1 të programit për datën e sipërpërmendur të pagesës kryesore (Pjesa fillestare e kështit) dhe emërtesit i së cilës është shumt e të gjitha pjesëve të mbetura të kështit fillestar për datat e pagesës kryesore që bien më ose fill pas një date të tillë, shumt e tilla të ripagueshme mund të përshtaten, sipas nevojës, për të zbritur çdo shumë të përmendur në paragrafin 4 të këtij programi, ndaj të cilit aplikohet një tabelë e konvertimit.

3. a) Sasitë e huasë së tërhequr brenda dy muajve kalendarikë para datës së pagesës kryesore do të trajtohen, për hir të përllogaritjes së sasive kryesore të pagueshme më datën e pagesës kryesore, si të tërhequra ose të prapambetura në datën e dytë të pagesës kryesore në vijim të datës së tërheqjes dhe do të jenë të ripagueshme më secilën datë të pagesës kryesore duke filluar me datën e dytë të pagesës kryesore në vijim të datës së tërheqjes.

b) Pavarësisht dispozitave të nënparagrafit a) të këtij paragrafi, nëse Banka në një kohë të dhënë adopton një sistem të përcaktuar faturimi sipas së cilës faturat lëshohen më ose pas datës së pagesës respektive kryesore, dispozitat e nënparagrafit të tillë nuk do të aplikojnë më për çdo tërheqje të bërë pas adoptimit të një sistemi të tillë faturimi.

4. Pavarësisht dispozitave të paragrafëve 1 dhe 2 të këtij programi, në vijim të aplikimit të konvertimit të monedhës për të gjithë ose pjesë të bilancit të tërhequr të huasë ndaj një monedhe të miratuar, sasitë e konvertuara në monedhën e miratuar që është e ripagueshme për çdo datë të pagesës kryesore që ndodh gjatë periudhës së konvertimit, do të përcaktohet nga Banka duke shumëzuar secilën shumë në monedhën e emërtuar menjëherë para konvertimit ose me: i) kursin e shkëmbimit që reflekton sasitë e pagesës kryesore në Monedhën e miratuar të pagueshme nga Banka sipas transaksionit të monedhës mbrojtëse që lidhet me konvertimin; ose ii) në qoftë se Banka vendos kështu në përputhje me udhëzimet e konvertimit, komponenti i kursit të shkëmbimit të normës nëpërmjet ekranit.

SHTOJCA PËRKUFIZIMET

1. “Agjencia e Trafikut Ajror” do të thotë Agjencia Kombëtare e Trafikut Ajror nën përgjegjësinë e MPPTT (siç përcaktohet këtu).

2. “Udhëzimet antikorruption” do të thotë “udhëzime për parandalimin dhe luftën kundër mashtrimit dhe korruptionit në projektet e financuara nga kredia e IBRD dhe kreditë e grantet e IDA-s, të datës 15 tetor 2006.

3. “Kategori” do të thotë kategoria e vendosur në seksionin IV të programit 4 të kësaj Marrëveshjeje.

4. “Udhëzimet e konsulentit” do të thotë “Udhëzimet: Përzgjedhja dhe punësimi i konsulentëve nga Përfituesi i Bankës Botërore” botuar nga Banka në muajin maj 2004 dhe të rishikuar

në tetor 2006.

5. “Drejtoria për emergjencat civile” do të thotë drejtoria në ngarkim të _____ brenda MB (siç njihet këtu).

6. “Vendimet për shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme” do të thotë vendimi i Këshillit të Ministrave nr.644 të përfituesit me titull “Kriteret dhe procedurat për shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme” të datës _____, 2002, e cila është amenduar në datën e kësaj Marrëveshjeje.

7. “Marrëveshje ekzekutimi” do të thotë marrëveshje e nënshkruar midis Përfituesit, përmes _____, dhe IEUM-së (siç do të referohet këtu) në përputhje me dispozitat e paragrafit 1 të seksionit 1.B të programit 2 të kësaj Marrëveshjeje, meqenëse kjo mund të amendohet herë pas here.

8. “Marrëveshja financiare” do të thotë Marrëveshje financiare për projektin midis Përfituesit dhe Shoqatës, që mban të njëjtën datë si kjo Marrëveshje, meqenëse një marrëveshje e tillë financiare mund të amendohet herë pas here: “Marrëveshje financiare” përfshin të gjitha shtojcat, programet dhe marrëveshjet që janë shtojca të Marrëveshjes financiare.

9. “Kushtet e përgjithshme” do të thotë “Kushtet e përgjithshme të Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për huatë”, e datës 1 korrik 2005 (e amenduar më 12 shkurt 2008).

10. “Instituti i Energjisë, Ujit dhe Mjedisit” ose “IEUM” Instituti për Mjedisin, Ujin dhe Energjinë të Përfituesit, një institucion qeveritar përgjegjës për shërbimet ndaj palëve të treta dhe përgjegjës për transferimin e njohurive dhe të teknologjisë në sektorët e energjisë, ujit, mjedisit dhe sektorët klimatikë.

11. “Legjislacioni për funksionimin e IEUM” do të thotë _____ e datës _____, dhe vendimi i Këshillit të Ministrave të Përfituesit nr.560, datë 22 gusht 2007 që lidhet me IEUM, e amenduar sipas datës së kësaj Marrëveshjeje.

12. “Viti fiskal” do të thotë dymbëdhjetë (12) muaj që korrespondojnë me vitet fiskale të Përfituesit, periudhë e cila fillon më 1 janar dhe përfundon më 31 dhjetor në secilin vit kalendarik.

13. “Ministria e Mbrojtjes” ose “MM” do të thotë Ministria e Mbrojtjes së Përfituesit.

14. “Ministria e Arsimit dhe Shkencës ose “MASH” do të thotë Ministria e Arsimit dhe Shkencës e Përfituesit.

15. “Ministria e Financave” ose “MF” do të thotë Ministria e Financave e Përfituesit, ose çdo titull pasues pas kësaj.

16. “Ministria e Brendshme” ose “MB” do të thotë Ministria e Brendshme e Përfituesit, ose çdo titull pas kësaj.

17. “Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit” ose “MPPTT” do të thotë Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit e Përfituesit ose çdo titull pasues pas kësaj.

18. “Monitorimi dhe vlerësimi i indikatorëve” do të thotë monitorimi dhe vlerësimi i indikatorëve të miratuar siç përshkruhen në letër, e cila do të përdoret nga Përfituesi për të matur progresin e shënuar në implementimin e projektit dhe shkallën e arritjes së objektivave të tij.

19. “Udhëzimet e prokurimit” do të thotë “Udhëzimet: Prokurimet sipas huasë IBRD dhe kredisë IDA” të botuara nga Banka në muajin maj 2004 dhe të rishikuara në tetor 2006.

20. “Plani i prokurimeve” do të thotë plan prokurimesh për projektin, të datës _____ dhe të përmendur në paragrafin 1.16 të udhëzimeve të prokurimit dhe paragrafin 1.24 të udhëzimeve të konsulentëve, meqenëse të dyja do të përditësohen herë pas here në përputhje me dispozitat e paragrafit të sipërpërmendur.

21. “Kompania e Sigurimeve ndaj Riskut të Katastrofave në Europën Juglindore” ose “CRIF” do të thotë programi i sigurimit ndaj riskut rajonal të katastrofave, i cili do të jetë nën kontrollin e vendeve të Europës Juglindore, ku Përfituesi do të bëhet pjesë sipas pjesës 4.1 të projektit.

LIGJ

Nr.9962, datë 21.7.2008

**PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR.8410, DATË 30.9.1998 “PËR RADION DHE
TELEVIZIONIN PUBLIK E PRIVAT NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e një deputeti,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Në ligjin nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, pas nenit 65 shtohet neni 65/a me këtë përmbajtje:

“Neni 65/a

Pronat e paluajtshme të Radiotelevizionit Shqiptar janë pronë publike, në përputhje me ligjin nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar dhe regjistrohen nga Këshilli i Ministrave në Regjistrin e Pronave të Paluajtshme, me pronar Republikën e Shqipërisë.”.

Neni 2

Dispozitë kalimtare

30 ditë pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, Këshilli Drejtues i RTSH-së miraton ndryshimet përkatëse në statutin e RTSH-së dhe ia dërgon Kuvendit për miratim.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5840, datë 29.7.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

LIGJ

Nr.9963, datë 21.7.2008

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.9376, DATË 21.4.2005 “PËR SPORTIN”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 e 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.9376, datë 21.4.2005 “Për sportin”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa e ndryshime:

Neni 1

Në nenin 10/1, në fund të pikës 1 shtohet fjalia me këtë përmbajtje:

“Mënyra e përdorimit të këtij fondi përcaktohet me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Financave dhe të Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve”.

Neni 2

Neni 26 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 26

1. Federatat shqiptare dhe klubet sportive, me fondet publike, të dhëna nga pushteti qendror e vendor, financojnë trajtimin për përgatitjen sportive dhe shpërblimin e sportistëve cilësorë dhe të trajnerëve të tyre, për arritjen e rezultateve të larta sportive.

2. Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, me propozimin e federatave sportive, u jep shpërblime të veçanta sportistëve dhe trajnerëve të tyre, për rezultate të larta në veprimtaritë ndërkombëtare sportive.

3. Kriteret për përcaktimin e rezultateve të larta sportive, kombëtare e ndërkombëtare, masa dhe mënyra e shpërblimit, si dhe përfitimi i trajtimit për përgatitjen sportive përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 3

Neni 31 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 31

Objektet sportive privatizohen nga pronarët e truallit, kur ka të tillë, në të kundërt, jepen me koncesion, në përputhje me ligjin nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike dhe infrastrukturë”, me kusht që të mos u ndryshojë destinacioni.”.

Neni 4

Neni 33/1 shfuqizohet.

Neni 5

Në nenin 37, fjalët “të ardhurat nga shitja e së drejtës radiotelevizive” hiqen.

Neni 6

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.5841, datë 29.7.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

LIGJ

Nr.9966, datë 24.7.2008

**PËR DISA SHTESA NË LIGJIN NR.9396, DATË 12.5.2005 “PËR QIRANË FINANCIARE”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Në ligjin nr.9396, datë 12.5.2005 “Për qiranë financiare”, të ndryshuar, bëhen këto shtesa:

Neni 1

Pas nenit 43 shtohet neni 43/1 me këtë përmbajtje:

**“Neni 43/1
Mbikëqyrja**

Veprimtaria e qiradhënies financiare, si dhe të gjitha subjektet që kryejnë këtë veprimtari licencohen dhe mbikëqyren nga Banka e Shqipërisë, në përputhje me dispozitat e këtij ligji, të ligjit “Për bankat në Republikën e Shqipërisë” dhe akteve nënligjore të nxjerra prej saj për këtë qëllim.”.

Neni 2

Në nenin 44, pas emërimit “Ministri i Ekonomisë” shtohet emërtimi “Banka e Shqipërisë”.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.5849, datë 30.7.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

**LIGJ
Nr.9967, datë 24.7.2008**

**PËR MIRATIMIN E AKTIT NORMATIV, ME FUQINË E LIGJIT, NR.4, DATË 9.7.2008, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR PRIVATIZIMIN DHE DHËNIEN NË PËRDORIM
SHOQËRIVE TREGTARE DHE INSTITUCIONEVE SHTETËRORE TË NDËRMARRJEVE
APO OBJEKTEVE TË VEÇANTA, MJETEVE KRYESORE DHE MJETEVE TË XHIROS SË
KËTYRE NDËRMARRJEVE”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 101 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

**K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

VENDOSI:

Miratohet akti normativ, me fuqinë e ligjit, nr.4, datë 9.7.2008, i Këshillit të Ministrave “Për privatizimin dhe dhënien në përdorim shoqërive tregtare dhe institucioneve shtetërore të ndërmarrjeve apo objekteve të veçanta, mjeteve kryesore dhe mjeteve të xhiros së këtyre ndërmarrjeve”.

**Shpallur me dekretin nr.5842, datë 29.7.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

**LIGJ
Nr.9968, datë 24.7.2008**

PËR MIRATIMIN E AKTIT NORMATIV, ME FUQINË E LIGJIT, NR.6, DATË 16.7.2008, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES NDËRMJET REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BASHKIMIT EUROPIAN, PËR PJESËMARRJEN NË OPERACIONIN USHTARAK TË BASHKIMIT EUROPIAN PËR MENAXHIMIN E KRIZAVE NË REPUBLIKËN E ÇADIT DHE REPUBLIKËN E AFRIKËS QENDRORE (OPERACIONI EUFOR TCHAD/RCA)””

Në mbështetje të neneve 12 pika 3, 78, 83 pika 1, 101 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Miratohet akti normativ, me fuqinë e ligjit, nr.6, datë 16.7.2008, i Këshillit të Ministrave “Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bashkimit Europian, për pjesëmarrjen në operacionin ushtarak të Bashkimit Europian për menaxhimin e krizave në Republikën e Çadit dhe Republikën e Afrikës Qendrore (Operacioni EUFOR Tchad/RCA)””.

Shpallur me dekretin nr.5843, datë 29.7.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi

MARRËVESHJE

**NDËRMJET BASHKIMIT EUROPIAN DHE REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
PËR PJESËMARRJEN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË OPERACIONIN USHTARAK TË
BASHKIMIT EUROPIAN NË REPUBLIKËN E ÇADIT DHE NË REPUBLIKËN E AFRIKËS
QENDRORE (OPERACIONI EUFOR TCHAD/RCA)**

Bashkimi Europian (BE) nga njëra anë dhe Republika e Shqipërisë nga ana tjetër, tani e më poshtë të quajtur “Palë”,

duke pasur parasysh:

- *Miratimin* nga Këshilli i Bashkimit Europian të Veprimit të Përbashkët 2007/677/CFSP të 15 tetorit 2007, për operacionin ushtarak të BE-së në Republikën e Çadit dhe në Republikën e Afrikës Qendrore¹ (Operacioni EUFOR Tchad/RCA);

- *Ftesën* për Republikën e Shqipërisë për të marrë pjesë në operacionet e drejtuara nga BE-ja;

- *Përfundimin* e suksesshëm të procesit të Gjenerimit të Forcës dhe rekomandimet e Komandantit të Operacionit të BE-së dhe Komitetit Ushtarak të BE-së për pranimin e pjesëmarrjes së forcave të Republikës së Shqipërisë në operacionet e drejtuara nga BE-ja;

- *Vendimin* e Komitetit të Politikave dhe Sigurisë CHAD/1/2008 të 13 shkurtit 2008 mbi pranimin e kontributit e shteteve të treta në operacionin ushtarak të BE-së në Republikën e Çadit dhe në Republikën e Afrikës Qendrore;

- *Vendimin* e Komitetit të Politikave dhe Sigurisë CHAD/2/2008, datë 18 mars 2008 për krijimin e Komitetit të Kontribuesve për operacionin ushtarak të BE-së në Republikën e Çadit dhe në Republikën e Afrikës Qendrore;

kanë rënë dakord si më poshtë.

Neni 1

Pjesëmarrja në operacion

1. Republika e Shqipërisë do t'i bashkohet Veprimit të Përbashkët 2007/677/CFSP të 15 tetorit 2007 për operacionin ushtarak të BE-së në Republikën e Çadit dhe në Republikën e Afrikës Qendrore dhe çdo veprimi të përbashkët ose vendimi me të cilin Këshilli i BE-së vendos të zgjerojë operacionin ushtarak të tij për menaxhimin e krizave, në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje dhe çdo

¹ OJ L 279, 23.10.2007, p.21.

masë të nevojshme për zbatim.

2. Kontributi i Republikës së Shqipërisë në operacionin ushtarak të BE-së për menaxhimin e krizës nuk do të ndikojë në autonominë vendimmarrëse të BE-së.

3. Republika e Shqipërisë do të sigurojë që forcat dhe personeli i saj, pjesëmarrës në operacionin ushtarak të BE-së për menaxhimin e krizës, të marrin përsipër misionin e tyre në përputhje me:

- Veprimin e Përbashkët 2007/677/CFSP dhe amendamentet e mundshme pasuese;
- Planin e Operacionit;
- Masat zbatuese.

4. Forcat dhe personeli ndihmës për operacionin nga Republika e Shqipërisë do të kryejë detyrat dhe do të veprojnë duke pasur parasysh vetëm interesin e operacionit ushtarak të BE-së për menaxhimin e krizës.

5. Republika e Shqipërisë do të informojë Komandantin e Operacionit të BE-së në kohën e duhur për çdo ndryshim të pjesëmarrjes së saj në operacion.

Neni 2

Statusi i forcave

1. Statusi i forcave dhe personelit që kontribuon në operacionin ushtarak të BE-së për menaxhimin e krizës, nga Republika e Shqipërisë, do të rregullohet nga dispozitat e statusit të forcave, nëse ka, të pranura midis BE-së dhe shteteve të interesuara.

2. Statusi i forcës dhe personelit që kontribuon në shtabet e përgjithshme dhe elementet e komandës së vendosur jashtë Republikës së Çadit dhe Republikës së Afrikës Qendrore, do të rregullohet nga marrëveshjet mes shtabeve të përgjithshme dhe elementeve të komandave të interesuara dhe Republikës së Shqipërisë.

3. Pa cenuar dispozitat e statusit të forcës të referuar në paragrafin 1, Republika e Shqipërisë do të ushtrojë juridiksion mbi forcat dhe personelin e saj, pjesëmarrës në operacionin ushtarak të BE-së për menaxhimin e krizës.

4. Republika e Shqipërisë ka përgjegjësinë për t'iu përgjigjur çdo pretendimi lidhur me pjesëmarrjen në operacionin ushtarak të BE-së për menaxhimin e krizës, që rrjedh ose lidhet me personelin dhe forcat e saj. Republika e Shqipërisë do të jetë përgjegjëse për çdo veprim të ndërmarrë, veçanërisht ligjor apo disiplinor, ndaj forcave dhe personelit të saj, në përputhje me ligjet dhe rregullat e saj.

5. Republika e Shqipërisë merr përsipër të bëjë një deklaratë përsa i përket heqjes dorë nga pretendimet ndaj çdo shteti pjesëmarrës në operacionin ushtarak të BE-së për menaxhimin e krizës, dhe ta bëjë këtë me nënshkrimin e kësaj Marrëveshjeje.

6. Bashkimi Europian merr përsipër të sigurojë që shtetet anëtare do të bëjnë një deklaratë përsa i përket heqjes dorë nga pretendimet, për pjesëmarrjen e Republikës së Shqipërisë në operacionin ushtarak të BE-së për menaxhimin e krizës, dhe ta bëjnë këtë me nënshkrimin e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 3

Informacioni i klasifikuar

1. Republika e Shqipërisë do të marrë masat e duhura për të siguruar që informacioni i klasifikuar i BE-së të mbrohet në përputhje me rregullat e sigurisë së Këshillit të Bashkimit Europian, të cilat përmbahen në vendimin e Këshillit nr.2001/264/EC të 19 marsit 2001¹, dhe në përputhje me udhëzime të tjera të lëshuara nga autoritetet kompetente, përfshirë edhe Komandantin e Operacionit të BE-së.

2. Nëse BE dhe Republika e Shqipërisë kanë arritur një marrëveshje për procedurat e sigurisë në shkëmbimin e informacionit të klasifikuar, dispozitat e kësaj Marrëveshjeje do të zbatohen në

¹ OJ L 101,11.4.2001,p.1. vendimi është ndryshuar së fundmi me vendimin 2007/438/EC (OJ L 164, 26.6.2007,p.24).

kontekstin e operacionit ushtarak të BE-së për menaxhimin e krizës.

Neni 4

Zinxhiri i komandimit

1. Të gjitha forcat dhe personeli pjesëmarrës në operacionin ushtarak të BE-së për menaxhimin e krizës do të mbeten në komandën e plotë të autoriteteve të tyre kombëtare.

2. Autoritetet kombëtare do ta transferojnë Komandën Operacionale dhe Taktike dhe/ose kontrollin e forcave dhe personelit të tyre te Komandanti i Operacionit të BE-së. Komandanti i Operacionit të BE-së ka të drejtë të delegojë autoritetin e tij.

3. Republika e Shqipërisë do të ketë po ato të drejta dhe detyrime, përsa i përket menaxhimit të përditshëm të operacionit, si edhe Shtetet Anëtare të BE-së pjesëmarrëse në këtë operacion.

4. Komandanti i Operacionit të BE-së, pas këshillimit me Republikën e Shqipërisë, mund të kërkojë në çdo kohë tërheqjen e kontributit të Republikës së Shqipërisë.

5. Një Përfaqësues Ushtarak i Lartë (SMR) do të caktohet nga Republika e Shqipërisë për të përfaqësuar kontingjentin kombëtar në operacionin ushtarak të BE-së për menaxhimin e krizës. Përfaqësuesi Ushtarak i Lartë (SMR) do të këshillohet me Komandantin e Operacionit të BE-së për të gjitha çështjet që lidhen me operacionin dhe do të jetë përgjegjës për disiplinën e përditshme të kontingjentit.

Neni 5

Aspektet financiare

1. Republika e Shqipërisë do të marrë përsipër të gjitha shpenzimet që lidhen me pjesëmarrjen në operacion, përveç kur, këto shpenzime i nënshtrohen financimit të përbashkët siç parashikohet në instrumentet ligjore referuar në nenin 1 (1) të kësaj Marrëveshjeje, si dhe në vendimin e Këshillit 2007/384/CFSP të 14 majit 2007 që përcakton mekanizmin për të administruar financimin e shpenzimeve të përbashkëta të operacioneve të BE-së që kanë të bëjnë me mbrojtjen dhe çështjet ushtarake¹.

2. Në rast vdekje, plagosje, humbje ose dëmtime të personave fizikë ose juridikë të shtetit(eve) në të cilin kryhet operacioni, Republika e Shqipërisë, kur është vërtetuar përgjegjësia e saj, do të paguajë dëmshpërblim, sipas kushteve të parashikuara në dispozitat për statusin e forcave, nëse ka, siç referohet në nenin 2(1) të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 6

Masat për zbatimin e Marrëveshjes

Çdo masë teknike dhe administrative e nevojshme gjatë zbatimit të kësaj Marrëveshjeje, do të vendoset ndërmjet Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Bashkimit European/Përfaqësuesit të Lartë për Politikën e Jashtme e të Sigurisë së Përbashkët dhe autoriteteve përkatëse të Republikës së Shqipërisë.

Neni 7

Mospërputhjet

Nëse njëra nga Palët do të dështojë në përmbushjen e detyrimeve të saj, të parashtuara në nenet e mësipërme, Pala tjetër ka të drejtën t'i japë fund kësaj Marrëveshjeje duke njoftuar një muaj përpara.

Neni 8

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Mosmarrëveshjet lidhur me interpretimin ose zbatimin e kësaj Marrëveshjeje do të zgjidhen

¹ OJ L 152, 13.6.2007, p. 14.

me mënyra diplomatike midis Palëve.

Neni 9 Hyrja në fuqi

1. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi ditën e parë të muajit të parë pasi Palët të kenë njoftuar njëra-tjetrën për përfundimin e procedurave të brendshme të nevojshme për këtë qëllim.

2. Kjo Marrëveshje do të zbatohet me rezerva nga data e nënshkrimit.

3. Kjo Marrëveshje do të qëndrojë në fuqi për aq kohë sa zgjat edhe kontributi i Republikës së Shqipërisë në këtë operacion.

Bërë në Bruksel, më _____ në katër kopje në gjuhën angleze.

DEKLARATAT REFERUAR NË NENIN 2 (5) DHE (6) TË MARRËVESHJES DEKLARATA E SHTETEVE ANËTARE TË BE-SË:

“Shtetet Anëtare të BE-së, duke zbatuar Veprimin e Përbashkët të Bashkimit European 2007/677/CFSP të datës 15 tetor 2007 për operacionin ushtarak të Bashkimit European në Republikën e Çadit dhe në Republikën e Afrikës Qendrore¹ (Operacioni EUFOR Tchad/RCA) do të përpiqen, për aq sa dhe sistemi i tyre i brendshëm ligjor e lejon, të heqin dorë sa të jetë e mundur nga pretendimet ndaj Republikës së Shqipërisë për plagosjen, vdekjen e personelit të tyre ose dëmtimet apo humbjet e çdo aseti të zotëruar prej tyre dhe e përdorur në operacionin e BE-së për menaxhimin e krizës, në qoftë se këto plagosje, vdekje, dëmtime apo humbje:

- janë shkaktuar nga personeli i Republikës së Shqipërisë gjatë kryerjes së detyrave të tyre në lidhje me operacionin e BE-së për menaxhimin e krizës, përveç rasteve të neglizhencës së madhe ose të veprimeve të gabuara të kryera me dashje; ose

- të shkaktuara nga përdorimi i çdo aseti të zotëruar nga Republika e Shqipërisë, me kusht që këto asete të jenë përdorur në lidhje me operacionin, përveç rasteve të neglizhencës së madhe ose të veprimeve të gabuara të kryera me dashje nga personeli i Republikës së Shqipërisë në operacionin e BE-së për menaxhimin e krizës, që përdor këto asete.”

DEKLARATA E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË:

“Republika e Shqipërisë duke i'u bashkuar Veprimit të Përbashkët të Bashkimit European 2007/677/CFSP të datës 15 tetor 2007 për operacionin ushtarak të Bashkimit European në Republikën e Çadit dhe në Republikën e Afrikës Qendrore² (Operacioni EUFOR Tchad/RCA) do të përpiqet, për aq sa dhe sistemi i saj i brendshëm ligjor e lejon, të heqë dorë sa të jetë e mundur nga pretendimet ndaj çdo shteti tjetër pjesëmarrës në operacionin e BE-së për menaxhimin e krizës, për plagosjen, vdekjen e personelit të saj, dëmtimet apo humbjet e çdo aseti të zotëruar prej saj dhe e përdorur në operacionin e BE-së për menaxhimin e krizës në qoftë se këto plagosje, vdekje, dëmtime apo humbje:

- janë shkaktuar nga personeli gjatë kryerjes së detyrave të tyre në lidhje me operacionin e BE-së për menaxhimin e krizës, përveç rasteve të neglizhencës së madhe ose të veprimeve të gabuara të kryera me dashje; ose

- të shkaktuara nga përdorimi i çdo aseti të zotëruar nga shtetet pjesëmarrëse në operacionin e BE-së për menaxhimin e krizës, me kusht që këto asete të jenë përdorur në lidhje me operacionin, përveç rasteve të neglizhencës së madhe ose të veprimeve të gabuara të kryera me dashje nga personeli në operacionin e BE-së për menaxhimin e krizës, që përdor këto asete.”

¹ OJ L 279, 23.10.2007, p. 21.

² OJ L 279, 23.10.2007, p. 21.

LIGJ
Nr.9970, datë 24.7.2008

PËR BARAZINË GJINORE NË SHOQËRI

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

PJESA I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti

Ky ligj rregullon çështjet themelore të barazisë gjinore në jetën publike, të mbrojtjes dhe trajtimit të barabartë të grave e burrave, për mundësitë dhe shanset e barabarta për ushtrimin e të drejtave, si dhe për pjesëmarrjen e ndihmesën e tyre në zhvillimin e të gjitha fushave të jetës shoqërore.

Neni 2

Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është:

- a) të sigurojë mbrojtje efikase nga diskriminimi për shkak të gjinisë dhe nga çdo formë sjelljeje, që nxit diskriminimin për shkak të gjinisë;
- b) të përcaktojë masa për garantimin e mundësive të barabarta ndërmjet grave e burrave, për të eliminuar diskriminimin e bazuar në gjini, në çfarëdo forme me të cilën shfaqet;
- c) të përcaktojë përgjegjësitë e autoriteteve shtetërore, qendrore dhe vendore, për të hartuar dhe zbatuar aktet normative, si dhe politikat që mbështesin zhvillimin dhe nxitjen e barazisë gjinore në shoqëri.

Neni 3

Parimet themelore

1. Ky ligj bazohet në parimin e barazisë e të mosdiskriminimit dhe në parimet e tjera, të sanksionuara nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, nga konventa “Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj gruas”, si dhe nga të gjitha aktet e tjera ndërkombëtare, të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.

2. Dispozitat e këtij ligji nuk duhet të interpretohen apo zbatohen në mënyrë që të kufizojnë apo reduktojnë garancitë për arritjen e barazisë gjinore, të shprehura në aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, *acquis communautaire* të Bashkimit Europian, konventa “Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj gruas”.

Neni 4

Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. “Barazi gjinore” është pjesëmarrja e barabartë e femrave dhe e meshkujve në të gjithat fushat e jetës, pozita e barabartë ndërmjet tyre, mundësi e shanse të barabarta, për të gëzuar të drejtat dhe për të përmbushur detyrimet në shoqëri, duke përfutur njëlloj nga arritjet e zhvillimit të saj.

2. “Përkatesi gjinore” janë mundësitë dhe atributet shoqërore, të lidhura me të qenit femër apo mashkull, si dhe marrëdhëniet ndërmjet tyre.

3. “Diskriminim për shkak të gjinisë” është çdo dallim, përjashtim ose kufizim mbi baza gjinore, që ka për qëllim ose për pasojë dëmtimin, mosnjohjen, mosgëzimin dhe mosushtrimin, në

mënyrë të barabartë, nga secila gjini, të të drejtave të njeriut dhe lirive të parashikuara në Kushtetutë dhe në ligje, në fushat politike, ekonomike, shoqërore, kulturore e civile.

4. “Integrim gjinor” është procesi që zhvillohet ndërmjet femrave dhe meshkujve, si një proces që nuk i përket vetëm njëres gjini si grup i veçuar, por shoqërisë në tërësi. Si i tillë, integrimi gjinor është rruga për arritjen e barazisë gjinore në shoqëri, nëpërmjet përfshirjes së perspektivës së secilës nga gjinitë në të gjitha proceset ligjvënëse, politikëbërëse, planifikuese, zbatuese e monitoruese.

5. “Përfaqësim i barabartë gjinor” është përfaqësimi i secilës prej gjinive me jo më pak se 30 për qind në një institucion, në nivel drejtues, organ të emëruar, parti politike.

6. “Masa të veçanta të përkohshme” janë masat e ndërmarra nga organet shtetërore, që synojnë përshejtimin e vendosjes së barazisë faktike ndërmjet femrave dhe meshkujve në shoqëri.

7. “Nëpunës që merret me çështjet e barazisë gjinore” është punonjësi i administratës publike, qendrore apo vendore, i cili ka formim dhe njohuri të posaçme në fushën e barazisë gjinore dhe ia kushton kohën e punës arritjes së barazisë gjinore dhe integritetit gjinor në sektorin apo territorin që mbulon.

8. “Punë me vlerë të barabartë” është veprimtaria e paguar, e cila, e krahasuar me të njëjtët tregues ose njësi matëse të një veprimtarie tjetër, pasqyron njohuritë e ngjashme ose të barabarta dhe aftësitë profesionale në realizimin e një sasie të barabartë dhe të përafërt të përpjekjeve fizike e intelektuale.

9. “Ngacmim për shkak të përkatësisë gjinore” është çdo formë sjelljeje e padëshiruar, që lidhet me gjininë e një personi dhe ka për qëllim dhe/ose sjell si pasojë cenimin e dinjitetit personal ose krijimin e një mjedisi kërcënues, armiqësor, poshtërues, përçmues apo fyes.

10. “Shqetësim seksual” është çdo formë e padëshiruar sjelljeje, e shprehur me fjalë ose veprime fizike dhe simbolike, me natyrë seksuale, e cila ka për qëllim ose sjell si pasojë cenimin e dinjitetit personal, në mënyrë të veçantë kur krijon një mjedis kërcënues, armiqësor, poshtërues, përçmues apo fyes.

Neni 5

Zbatimi i ligjit

1. Ky ligj mbron nga diskriminimi për shkak të gjinisë të gjithë personat, që jetojnë dhe qëndrojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.

2. Shtetasit shqiptarë, me banim të përkohshëm ose të përhershëm jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë, gëzojnë mbrojtjen, që ofron ky ligj, në marrëdhëniet me organet shtetërore shqiptare.

3. Personat fizikë e juridikë të huaj, me banim, vendqëndrim apo seli jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, gëzojnë mbrojtjen, që ofron ky ligj, në marrëdhëniet me organet shtetërore shqiptare.

Neni 6

Ndalimi i diskriminimit për shkak të gjinisë

1. Çdo trajtim më pak i favorshëm i një personi për shkak të gjinisë, në krahasim me trajtimin që i bëhet, i është bërë ose do t'i bëhej një personi të gjinisë tjetër, në një situatë të ngjashme, përbën diskriminim të drejtpërdrejtë për shkak të gjinisë dhe ndalohet.

2. Hartimi, zbatimi, nxitja dhe krijimi i dispozitave, kushteve, kriterëve apo praktikave, në dukje neutrale, por që sjellin vendosjen në një situatë më pak të favorshme të një personi të njërës gjini, krahasuar me personat e gjinisë tjetër, përbën diskriminim të tërthortë për shkak të gjinisë dhe ndalohet. Nga ky ndalim bëjnë përjashtim rastet kur këto dispozita, kushte, kriterë apo praktika justifikohen nga një qëllim i përligjur dhe mjetet apo rrugët për arritjen e këtij qëllimi janë të nevojshme dhe të përshtatshme.

Neni 7

Masat e nevojshme për sigurimin e barazisë gjinore

Për sigurimin e barazisë gjinore dhe eliminimin e diskriminimit për shkak të gjinisë, organet shtetërore, në bazë të kompetencave të tyre:

1. Sigurojnë, përmes masave legislative ose me mjete të tjera të përshtatshme, zbatimin praktik të parimit të barazisë gjinore.

2. Sigurojnë, përmes masave legislative ose me mjete të tjera të përshtatshme, të shoqëruar edhe me sanksione, kur është rasti, ndalimin e çdo diskriminimi për shkak të gjinisë.

3. Sigurojnë, përmes rregullimeve ligjore dhe nënligjore ose me mjete të tjera të përshtatshme, ndryshimin ose shfuqizimin e çdo akti ligjor, zakoni apo praktike, që përbën diskriminim për shkak të gjinisë.

4. Marrin të gjitha masat e përshtatshme, për të krijuar lehtësitë e nevojshme e të përligjura objektivisht, për mundësi të barabarta dhe akses të barabartë për të dyja gjinitë.

5. Sigurojnë, përmes institucioneve publike dhe gjykatave kombëtare, mbrojtjen efektive të të dyja gjinive ndaj çdo veprimi diskriminues.

Neni 8

Masat e veçanta të përkohshme

1. Masat e veçanta të përkohshme përfshijnë kuotat për të arritur përfaqësim të barabartë gjinor, rritjen e pjesëmarrjes së gjinisë më pak të përfaqësuar në vendimmarrje dhe në jetën publike, fuqizimin ekonomik dhe të pozitës së personave të secilës gjini në fushën e punës, përmirësimin në mënyrë të barabartë të nivelit arsimor, si dhe masa të tjera në çdo fushë, ku personat e njëres gjini nuk gëzojnë pozitë të barabartë me personat e gjinisë tjetër.

2. Nuk përbëjnë diskriminim për shkak të gjinisë rastet kur organet shtetërore marrin masa të veçanta të përkohshme, përfshirë edhe dispozita ligjore, që synojnë përsheptimin e vendosjes së barazisë faktike ndërmjet femrave dhe meshkujve. Këto masa duhet të pushojnë së ekzistuari sapo të jenë arritur objektivat e barazisë gjinore, për të cilat janë krijuar.

Neni 9

Masat e veçanta

Nuk përbëjnë diskriminim për shkak të gjinisë rastet kur shteti merr masa të veçanta, përfshirë edhe dispozita ligjore, që synojnë:

a) mbrojtjen e posaçme të grave gjatë shtatzënësisë dhe lindjes, të nënave të reja, si dhe të prindërve të rinj, për shkak të lindjes natyrore ose të adoptimit të fëmijës, duke krijuar kushte për mbrojtjen dhe lehtësimin e tyre në punë; në sigurimet shoqërore e ndihmat sociale; në sigurimin e ndihmës së nevojshme shëndetësore për nënën dhe fëmijën; në sigurimin dhe nxitjen e sistemit të shërbimeve sociale, duke favorizuar zhvillimin e rrjetit të çerdheve e kopshteve;

b) lehtësimin e ndihmën për personat, që kanë përgjegjësi të veçanta në familje, për shkak të përkujdesjes së përditshme ndaj anëtarëve të paafët të familjes, për shkak të moshës, paafetësisë fizike apo mendore ose për shkaqe të tjera paafetësie.

c) kufizimet për të punuar në disa sektorë të punëve të rënda dhe të rrezikshme për gratë shtatzëna dhe ato me fëmijë në gji. Këto kufizime do të rishikohen periodikisht, në varësi të njohurive shkencore e teknike dhe sipas nevojave që paraqiten.

PJESA II

ORGANET PËRGJEGJËSE PËR MBARËVAJTJEN E BARAZISË GJINORE DHE DETYRAT E TYRE

Neni 10

Këshilli i Ministrave

1. Këshilli i Ministrave miraton strategjinë kombëtare dhe planin e veprimit për arritjen e barazisë gjinore në Shqipëri.

2. Projektligjet e përgatitura nga Këshilli i Ministrave, që i paraqiten Kuvendit për miratim, nëse është rasti, duhet të shoqërohen edhe me një vlerësim të efekteve për secilën gjini.

Neni 11

Këshilli Kombëtar i Barazisë Gjinore

1. Këshilli Kombëtar i Barazisë Gjinore është organ këshillimor që ngrihet me urdhër të Kryeministrit, me propozim të ministrit që mbulon çështjet e barazisë gjinore. Përbërja e tij miratohet mbi bazën e përfaqësimit të barabartë, sipas përkatësisë gjinore.

2. Këshilli Kombëtar i Barazisë Gjinore kryesohet nga ministri që mbulon çështjet e barazisë gjinore dhe në përbërje ka dhjetë përfaqësues të përcaktuar nga Qeveria dhe tre nga shoqëria civile. Përfaqësuesit nga shoqëria civile duhet të jenë shtetas shqiptarë, me arsim të lartë dhe të njohur, për shkak të veprimtarisë së tyre në fushën e barazisë gjinore.

3. Mandati i anëtarëve të Këshillit Kombëtar të Barazisë Gjinore është 4 vjet, me të drejtë riemërimi, me përjashtim të anëtarëve që janë zgjedhur për shkak të detyrës. Në çdo rast, ripërtëritja e të gjithë anëtarëve të këshillit në të njëjtën kohë ndalohet.

4. Rregullat procedurale të funksionimit të Këshillit Kombëtar të Barazisë Gjinore, si dhe shpërblimi i anëtarëve të tij miratohen nga Këshilli i Ministrave në Rregulloren e Këshillit Kombëtar të Barazisë Gjinore.

Neni 12

Detyrat e Këshillit Kombëtar të Barazisë Gjinore

Detyrat e Këshillit Kombëtar të Barazisë Gjinore janë:

a) këshillon Qeverinë për përcaktimin e drejtimit të politikave shtetërore për barazi gjinore, me përjashtim të çështjeve që merren në shqyrtim nga Këshilli Kombëtar i Punës. Për çështje të një rëndësie të veçantë, Këshilli Kombëtar i Barazisë Gjinore mund të zhvillojë mbledhje të përbashkëta me Këshillin Kombëtar të Punës;

b) siguron integrimin gjinor në të gjitha fushat, sidomos në ato politike, shoqërore, ekonomike dhe kulturore;

c) i propozon Këshillit të Ministrave programet kryesore për nxitjen dhe arritjen e barazisë gjinore në Shqipëri;

ç) vlerëson gjendjen konkrete të barazisë gjinore në vend, duke dalë me udhëzime për strukturën e çështjeve të barazisë gjinore në ministrinë që mbulon çështjet e barazisë gjinore, si dhe propozime e rekomandime për Qeverinë, për përmirësimin e gjendjes;

d) miraton raportin vjetor për çështjet e barazisë gjinore të ministrisë që mbulon çështjet e barazisë gjinore.

Neni 13

Autoriteti shtetëror përgjegjës për zbatimin e ligjit dhe të programeve shtetërore për barazinë gjinore

1. Autoriteti shtetëror përgjegjës për zbatimin e këtij ligji, si dhe të programeve shtetërore për barazinë gjinore është ministri që mbulon çështjet e barazisë gjinore.

2. Ministri që mbulon çështjet e barazisë gjinore:

a) zbaton dhe mbikëqyr zbatimin e këtij ligji, strategjisë kombëtare dhe planit të veprimit për arritjen e barazisë gjinore, si dhe të detyrimeve ndërkombëtare të Republikës së Shqipërisë në fushën e barazisë gjinore;

b) i propozon Këshillit të Ministrave ndryshime ligjore e nënligjore, nënshkrimin e akteve ndërkombëtare në fushën e barazisë gjinore dhe të të drejtave të grave, si dhe ndërmarrjen e masave të tjera, që synojnë të zhdukin dallimet ndërmjet gjinive në gëzimin e të drejtave dhe ofrimin e mundësive, pasi këshillohet me Këshillin Kombëtar të Barazisë Gjinore;

c) bashkëpunon dhe u ofron mbështetje organizatave jofitimprurëse, aktive në fushën e barazisë gjinore;

ç) organizon edukimin dhe përgatitjen profesionale të nëpunësve për çështjet e barazisë gjinore;

d) ndërton mekanizmat e mbledhjes së statistikave, të ndara sipas gjinisë, në bashkëpunim me Institutin e Statistikave dhe me institucionet e tjera shtetërore, si dhe mbikëqyr mbledhjen dhe përpunimin e tyre;

dh) organizon grumbullimin, analizën dhe përhapjen e informacionit për problemet e përkatësisë gjinore;

e) vetë ose në bashkëpunim me institucione të tjera, ndërton dhe realizon veprimtari për edukimin, trajnimin, informimin dhe ndërgjegjësimin e qytetarëve, si dhe punonjësve e funksionarëve të administratës publike e sistemit gjyqësor mbi konceptin e barazisë gjinore, mosdiskriminimin e gruas, eliminimin e stereotipave gjinorë, kuptimin e drejtë të rolit të femrës e të mashkullit, të nënës e të babait në familje dhe shoqëri;

ë) brenda tremujorit të parë të çdo viti, i paraqet Këshillit Kombëtar të Barazisë Gjinore raportin e vitit paraardhës për veprimtarinë e realizuar, ecurinë e punës për arritjen e barazisë gjinore, problemet e hasura dhe rrugët për kapërcimin e tyre;

f) organizon mbledhjet e Këshillit Kombëtar të Barazisë Gjinore dhe përgatit materialet, aktet dhe dokumentet e nevojshme që paraprijnë ose pasojnë këto mbledhje.

3. Institucionet shtetërore, në nivel qendror dhe vendor, kanë detyrimin ligjor për të bashkëpunuar me ministrin përkatës, për shkëmbimin e informacionit dhe lehtësimin e përmbushjes së funksionit të tij. Për këtë qëllim, në çdo ministri emërohet një nëpunës që merret me çështjet e barazisë gjinore.

4. Ministri realizon detyrat e përcaktuara në pikën 2 të këtij neni, si dhe mbikëqyr veprimtarinë për çështjet e barazisë gjinore nëpërmjet strukturës që ai ka për këtë qëllim. Drejtuesi i kësaj strukture drejton këtë veprimtari, si dhe e përfaqëson strukturën në marrëdhëniet me të tretët.

5. Ministria për çështjet e barazisë gjinore ka burime financimi:

a) Buxhetin e Shtetit;

b) donatorë të ndryshëm.

Neni 14

Organet e qeverisjes vendore

1. Organet e qeverisjes vendore bashkëpunojnë me organet e qeverisjes qendrore për zbatimin e legjislationit dhe politikave shtetërore për barazinë gjinore.

2. Organet e qeverisjes vendore bashkëpunojnë ngushtë me organizatat jofitimprurëse për arritjen e barazisë gjinore në fusha të ndryshme, në territorin që mbulojnë.

3. Organet e qeverisjes vendore kryejnë mbledhjen dhe përpunimin e statistikave vendore, të ndara sipas gjinisë.

4. Organet e qeverisjes vendore emërojnë një ose disa nëpunës vendorë, që merren me çështje të barazisë gjinore, pranë tyre.

PJESA III

PJESËMARRJA E BARABARTË GJINORE NË PROCESIN E VENDIMMARRJES

Neni 15

Pjesëmarrja në procesin e vendimmarrjes

1. Përfaqësimi i barabartë gjinor në të gjitha organet e pushtetit legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor dhe në institucionet e tjera publike arrihet kur:

a) sigurohet përfaqësim në masën mbi 30 për qind për secilën gjini, përfshirë edhe në organet e tyre drejtuese;

b) sigurohet respektimi në mënyrë të njëjtë për secilën gjini i procedurave dhe kriterëve të konkurrimit, gjatë emërimit në këto organe;

c) sigurohet përfshirja mbi 30 për qind e secilës gjini në listën e kandidatëve për zgjedhjet në organet përfaqësuese vendore;

ç) sigurohet përfshirja jo më pak se 30 për qind e secilës gjini në listën e kandidatëve të paraqitur nga partitë politike për sistemin proporcional për zgjedhjet e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë;

d) sigurohet përfshirja mbi 30 për qind të secilës gjini në organet administruese të procesit të zgjedhjeve qendrore dhe vendore.

2. Partitë politike përcaktojnë mënyrat dhe masat për të përmbushur kërkesat e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni.

3. Partitë politike paguajnë një gjobë deri në një të dhjetën e fondit shtetëror për financimin e fushatës zgjedhore, nëse shkelin dispozitat e këtij neni, deri në ndreqjen e shkeljes.

PJESA IV
MBROJTJA DHE TRAJTIMI I BARABARTË, NË BAZË TË PÛRKATËSISË GJINORE, NË
MARRËDHËNIET E PUNËS

Neni 16

Detyrimet e punëdhënësit në marrëdhëniet e punës

Punëdhënësi dhe çdo individ, që vepron në emër dhe për llogari të tij, me cilësinë e ndërmjetësit, të agentit apo të përfaqësuesit, detyrohet që, për promovimin e barazisë gjinore para dhe gjatë marrëdhënieve të punës:

1. Të mos përfshijë elemente të diskriminimit në bazë të gjinisë në shpalljen e vendit të lirë të punës dhe të sigurojë mundësi të barabarta për femrat dhe meshkujt për të aplikuar në vendet e lira të punës.

Kur për një vend të lirë pune ose për një kategori të caktuar pune ka një shpërndarje të pabarabartë të femrave dhe meshkujve, nuk përbën diskriminim nëse shpallja vë në dukje qëllimin e vendosjes së parimeve të barazisë.

2. Të zbatojë kritere të njëjta në të gjitha procedurat e rekrutimit, me përjashtim të rasteve të veçanta, të përcaktuara në nenin 9 të këtij ligji.

Punëdhënësi nuk mund të disfavorizojë një punëkërkuar, duke vendosur rregulla, kritere ose metoda procedurale, që në dukje janë neutrale, por që në praktikë janë më pak të favorshme për personat e gjinisë tjetër, përveçse për shkaqe objektive dhe të arsyeshme.

3. Të punësojë pa diferencim gjinor, në çdo pozicion ose vend të lirë, në të gjitha nivelet e hierarkisë profesionale.

4. Të promovojë shpërndarje të barabartë, ndërmjet femrave dhe meshkujve, në lloje të ndryshme të vendeve të punës dhe brenda kategorive të ndryshme të punëmarrësve, përmes trajnimit dhe zhvillimit të aftësive profesionale e të masave të tjera të përkohshme.

5. Të krijojë kushte pune të barabarta dhe të përshtatshme, mundësi të barabarta për informacion, trajnim e kualifikim dhe trajtim të barabartë të punëmarrësve gjatë marrëdhënieve të punës.

6. Të zbatojë kritere të barabarta në vlerësimin e cilësisë së punës. Punëdhënësi nuk mund të zbatojë një kriter vlerësues, në dukje neutral, por që në praktikë është në disavantazh të personave të gjinisë tjetër.

7. Të japë pagesë të barabartë për punë me vlerë të barabartë.

8. Të marrë masa për ndalimin e diskriminimit, ngacmimeve dhe shqetësimeve seksuale ndaj punëmarrësit.

9. Të mos vendosë në pozitë të disfavorshme ose të mos marrë masa disiplinore ndaj punëmarrësit, i cili kundërshton ose ankohet për diskriminim, ngacmim ose shqetësim seksual, si edhe ndaj punëmarrësit që dëshmon për veprime diskriminuese, ngacmim ose shqetësim seksual, të kryera prej punëdhënësit ose punëmarrësve të tjerë.

Neni 17

Veprimet diskriminuese të punëdhënësit

1. Veprimet e punëdhënësit në sektorin publik ose privat janë diskriminuese, nëse, për shkak të gjinisë:

a) përdor standarde ose/dhe procedura të diferencuara ndaj punëmarrësve për rekrutimin, trajnimin dhe ritrajnimin, promovimin në detyrë, nxitjen profesionale, menaxhimin dhe shpërndarjen e punës, kohëzgjatjen dhe kushtet e provës, sigurimet shoqërore dhe përfitimet në rastet e daljes në pension, papunësisë, sëmundjes, invaliditetit, paaftësisë për punë, të drejtën e lejes dhe të lejes së paguar, mbrojtjen e shëndetit dhe të sigurisë në punë, pagesën për punë me vlerë të barabartë, pjesëmarrjen në organizatat sindikale, përveçse për shkaqe objektive dhe të arsyeshme, të parashikuara

në nenin 9 të këtij ligji;

b) krijon kushte pune të diferencuara për punëmarrësit e të njëjtit nivel;

c) ndërmerr dënim disiplinor ndaj punëmarrësit, ndryshon kushtet e punës, e transferon në një punë tjetër, shkurton vende pune, pushon apo largon nga puna ose përfundon kontratën e punës;

ç) vendos në pozitë të disfavorshme punëmarrësin, për shkak të një ankese ndaj veprimeve të mësipërme të punëdhënësit.

2. Ndalohet diskriminimi në përzgjedhjen e një kandidati për punë dhe përfundimi i marrëdhënieve të punës nga punëmarrësi për shkaqe të mëmësisë, mundësisë për shtatzënësi në të ardhmen, shtatzënësisë, përgjegjësisë prindërore, gjendjes civile, përgjegjësiwe familjare. Nuk përbën diskriminim nëse vendi i punës është përcaktuar nga Këshilli i Ministrave si i vështirë ose i rrezikshëm për shëndetin e nënave me fëmijë në gjë dhe për gratë shtatzëna.

3. Gjatë proceseve të riorganizimit dhe reformimit të vendeve të punës, punëdhënësi respekton rregullat e përfaqësimit të barabartë gjinor në përfundimin e marrëdhënieve të punës.

Neni 18

Përgjegjësitë e punëdhënësit për mbrojtjen e punëmarrësit nga diskriminimi, ngacmimi dhe shqetësimi seksual

1. Çdo diskriminim, ngacmim apo shqetësim seksual në vendin e punës nga punëdhënësi dhe/ose punëmarrësi është i ndaluar.

2. Punëdhënësi, për të mbrojtur punëmarrësit nga diskriminimi, ngacmimi e, veçanërisht, nga shqetësimi seksual, detyrohet:

a) të marrë masa parandaluese dhe të përcaktojë masa (sanksione) disiplinore në rregulloren e brendshme, për ndalimin e ngacmimeve dhe të shqetësimeve seksuale ndaj punëmarrësit, në përputhje me këtë ligj;

b) nëse merr dijeni, në mënyrë të tërthortë ose me ankesë nga një punëmarrës, i cili pretendon se është diskriminuar, ngacmuar ose shqetësuar seksualisht nga një punëmarrës tjetër, pasi bindet, merr masat e duhura organizative për ndalimin e vazhdimet dhe parandalimin e diskriminimit, të ngacmimit ose shqetësimit seksual dhe zbaton sanksionet disiplinore;

c) të informojë të gjithë punëmarrësit për ndalimin e diskriminimit, të ngacmimit dhe shqetësimit seksual në vendin e punës.

3. Punëdhënësi vendos në kontratën kolektive të punës rregulla për të parandaluar diskriminimin për shkak të gjinisë dhe për mënyrën e zgjidhjes së ankesave të bëra prej personave të dëmtuar nga akte të tilla.

4. Çdo marrëveshje individuale ose kontratë kolektive, që vjen në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, është e pavlefshme.

5. Dispozitat e këtij ligji i shtrijnë efektet e tyre edhe tek të vetëpunësuarit, si dhe për punëmarrësit, për punët që kryhen në kushtet e shtëpisë.

Neni 19

Autoriteti publik përgjegjës për barazinë gjinore në fushën e punës

1. Ministri që mbulon çështjet e barazisë gjinore është autoriteti publik përgjegjës për të zbatuar dhe kontrolluar respektimin e këtij ligji në fushën e punës dhe të punësimit.

2. Me qëllim që të zbatojnë masat për përmirësimin e mundësive të barabarta ndërmjet femrave dhe meshkujve, për eliminimin e diskriminimit të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, për shkak të përkatësisë gjinore, ministri që mbulon çështjet e barazisë gjinore organizon mbikëqyrjen dhe ushtron kontroll ndaj institucioneve që varen prej tij, të cilat ndjekin problemet e barazisë gjinore, si më poshtë:

a) Shërbimi Kombëtar i Punësimit siguron zbatimin e masave për mbikëqyrjen e mundësive dhe të trajtimit të barabartë ndërmjet burrit dhe gruas në fushën e shërbimit të punësimit dhe të formimit profesional, si dhe në mbështetjen me të ardhura nga papunësia, kontrollon marrjen dhe zbatimin e masave të veçanta, të përkohshme, nga punëdhënësi, si dhe i paraqet ministrit që mbulon çështjet e barazisë gjinore propozime për ndryshime në ligje e akte nënligjore, çdo nismë e projekte, studime e bashkëpunime të tjera në fushën e barazisë gjinore;

b) Inspektorati Shtetëror i Punës siguron kontrollin dhe zbatimin e masave për respektimin e barazisë gjinore në fushën e marrëdhënieve të punës e të punësimit, të sigurimeve shoqërore e shëndetësore, të sigurisë në punë prej punëdhënësit dhe personave të punësuar në sektorin publik e privat, si dhe kontrollon marrjen dhe zbatimin e masave të veçanta të përkohshme nga punëdhënësi;

c) Shërbimi Social Shtetëror inspekton dhe përgjigjet për zbatimin e masave për respektimin e parimeve të barazisë gjinore në fushën e zbatimit të politikave dhe të legjislacionit të ndihmës ekonomike, pagesës për personat me aftësi të kufizuar dhe shërbimeve të përkujdesit shoqëror në të gjithë vendin.

3. Ministri që mbulon çështjet e barazisë gjinore bashkëpunon me Ministrin e Financave, me qëllim që Instituti i Sigurimeve Shoqërore të sigurojë zbatimin e masave për mbikëqyrjen e barazisë gjinore në fushën e administrimit dhe të menaxhimit të sistemit publik të pensioneve dhe të të drejtave të tjera të sigurimit shoqëror.

4. Mënyrat, format dhe fushat konkrete të bashkëpunimit në fushën e barazisë gjinore ndërmjet institucioneve, në varësi të ministrisë që mbulon çështjet e barazisë gjinore dhe ministrive të tjera, përcaktohen me akte nënligjore.

Neni 20

Njoftimet diskriminuese

1. Përbën diskriminim një njoftim pune, arsimimi, kualifikimi ose trajnimi, kur në të përcaktohen kërkesa ose preferenca, të cilat i japin përparësi aplikuesit të një gjinie të caktuar, me përjashtim të rasteve të veçanta, të përcaktuara në nenin 9 të këtij ligji, për shkak të natyrës së veçantë të punës.

2. Përbën diskriminim një njoftim pune/arsimimi, i cili përmban kërkesa, që nuk kanë lidhje me vendin e punës/arsimit ose që mund të përjashtojë një femër/mashkull nga aplikimi, ose që të lë përshtypjen e parapëlqimeve ndaj një gjinie të caktuar, përveçse për shkaqe objektive dhe të arsyeshme.

3. Përbën diskriminim specifikimi në njoftim i kërkesave ose parapëlqimeve, që kanë të bëjnë me gjendjen familjare e martesore apo me detyrimet familjare.

4. Në njoftimet e punës është e ndaluar të kërkohet nga njoftuesi informacion rreth jetës private ose familjare të aplikuesit.

5. Njoftimi nuk është diskriminues nëse gjinia e përfaqësuar në nivelin më të ulët (duke pasur parasysh vendin e punës dhe postin) nxitet të aplikojë.

Neni 21

Të drejtat e punëmarrësit për respektimin e parimeve të barazisë gjinore

Punëmarrësit femra dhe meshkuj kanë të drejtë që pa asnjë diskriminim për shkak të gjinisë:

a) të zgjedhin lirisht profesionin dhe vendin e punës, sistemin e përgatitjes dhe përsosjes profesionale dhe të kualifikimit të pandërprerë, të mësimin të zanateve, të ngrihen në përgjegjësi, të kenë punë të qëndrueshme;

b) të kenë të njëjtat mundësi punësimi, përfshirë zbatimin e të njëjtave kritere të përzgjedhjes për punësim;

c) të informohen nga punëdhënësi për vendet e lira të punës dhe të drejtat e tyre mbi mundësitë e barabarta në marrëdhëniet e punës;

ç) të kenë pagë të barabartë për punë me vlerë të barabartë, përfshirë shpërblimet, për trajtim të barabartë për punë me vlerë të barabartë, si dhe për trajtim të barabartë lidhur me vlerësimin e cilësisë së punës;

d) të kenë sigurime shoqërore, veçanërisht në rastet e daljes në pension, të papunësisë apo të humbjes së aftësisë së përkohshme për punë;

dh) të kenë mbrojtjen e shëndetit dhe sigurimin në punë, përfshirë ruajtjen e funksionit të riprodhimit;

e) të mos diskriminohen ose pushohen nga puna për shkak të martesës ose gratë për shkak të shtatzënisë ose amësisë dhe të garantohet e drejta efektive për punë;

- e) të kenë të drejtë të përfitojnë kompensime për fëmijët që kanë në ngarkim;
- f) të kenë mbështetjen dhe inkurajimin e sistemit të shërbimeve sociale të nevojshme, për t'u lejuar prindërve punëmarrës të gërshetojnë detyrimet familjare me përgjegjësitë profesionale;
- g) të marrin informacion me shkrim nga punëdhënësi, pas paraqitjes së një kërkesë, lidhur me natyrën dhe qëllimin e trajnimit, eksperiencën në punë dhe të kualifikimeve të tjera që pati personi i gjinisë tjetër, i cili fitoi të drejtën, u përzgjedh, u promovua në një pozicion ose vend të lirë pune;
- gj) të anëtarësohen dhe të aktivizohen në organizatat sindikale dhe në çdo organizatë tjetër profesionale.

Neni 22

Masat e veçanta të përkohshme në fushën e marrëdhënieve të punës

1. Për të siguruar përfaqësim të barabartë në fushën e marrëdhënieve të punës, nuk përbën diskriminim nëse shpallja për një vend të lirë pune deklaron parapëlqim për kandidatin e gjinisë më pak të përfaqësuar.
2. Për të siguruar përfaqësim të barabartë në fushën e marrëdhënieve të punës, në procesin e përzgjedhjes për marrjen në punë, ngritjen në detyrë, zhvillimin e aftësive profesionale, kur kandidatët kanë rezultate ose nivele të barabarta, punëmarrësi i jep përparësi kandidatit të gjinisë më pak të përfaqësuar.

Neni 23

Vlerësimi i punës së papaguar

1. Puna e papaguar e femrave dhe e meshkujve vlerësohet kontribut për zhvillimin e familjes dhe të shoqërisë, në rast kur ai/ajo:
 - a) kujdeset për mirëqenien e familjes;
 - b) kujdeset për fëmijët;
 - c) kujdeset për anëtarë të tjerë të familjes;
 - ç) punon në bujqësi dhe ekonomi familjare.
2. Subjektet e përcaktuara në pikën 1 të këtij neni përfitojnë nga shërbimet në komunitet, politikat e punës dhe të punësimit, si dhe të formimit profesional në bazë të legjislacionit në fuqi.

PJESA V

TRAJTIMI I BARABARTË DHE MBROJTJA NGA DISKRIMINIMI PËR SHKAK TË GJINISË NË ARSIM DHE KUALIFIKIM

Neni 24

Ndalimi i pabarazisë për shkak të përkatësisë gjinore

1. Ndalohet diskriminimi, për shkak të përkatësisë gjinore, ndaj personave nga/në institucionet arsimore të të gjitha niveleve, publike ose private.
2. Përbëjnë diskriminim rastet kur:
 - a) parashikohen norma kufizuese, bazuar në dallime gjinore dhe pengohet krijimi i lehtësive të nevojshme për t'u arsimuar pranë institucioneve shtetërore ose private, që ofrojnë arsimim apo shërbime të tjera kualifikimi e trajnimi;
 - b) krijohen mundësi të ndryshme e të pajustificuara objektivisht ndaj burrit dhe gruas, për zgjedhjen e një fushe të veçantë studimi, trajnimi, diplomimi, si dhe për kohëzgjatjen e mësimi.

Neni 25

Edukimi i barazisë gjinore

1. Subjektet, që ofrojnë arsimim, kualifikim e trajnim, si dhe ata që formulojnë tekstet, programet dhe materialet e tjera mësimore, në të gjitha nivelet, sigurojnë mësimdhënien e njohurive të nevojshme dhe përdorin metoda mësimdhënieje, trajnimi e kualifikimi, në mënyrë të tillë që të ndihmojnë në promovimin, nxitjen dhe formimin e edukatës së barazisë dhe në ndalimin e diskriminimit për shkak të gjinisë, të stereotipave negativë, paragjykimeve dhe praktikave zakonore

ose të çdo lloji tjetër, që cenojnë parimet e barazisë gjinore.

2. Institucionet e arsimit të lartë, në mënyrë të veçantë, sipas fushave përkatëse, ndërmarrin nisma për kryerjen e studimeve në fushën e barazisë gjinore, ose e përfshijnë atë në studimet e kryera, për të siguruar materiale me informacionin përkatës, si dhe për t'i paraprirë zhvillimit praktik e shkencor të kësaj fushe.

PJESA VI TRAJTIMI I BARABARTË DHE MBROJTJA NGA DISKRIMINIMI PËR SHKAK TË GJINISË NË MEDIA

Neni 26

Barazia gjinore në media

1. Media ndihmon në rritjen e vetëdijes së përgjithshme për barazinë e femrave dhe të meshkujve:

- a) përmes raportimit jodiskriminues mbi baza gjinore;
- b) përmes përdorimit të terminologjisë neutrale në aspektin gjinor;
- c) përmes shmangies së stereotipave gjinorë në veprimtarinë e vet.

2. Ndalohet transmetimi, botimi dhe publikimi i materialeve dhe i informacioneve, që përmbajnë apo nënkuptojnë dallime poshtëruese apo fyese, përjashtime apo kufizime të njëres prej gjinive, në bazë të diskriminimit për shkak të gjinisë.

PJESA VII ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE DHE SANKSIONET

Neni 27

Masat disiplinore

Shkelja e nenit 18 pika 2 shkronja “b” të këtij ligji sjell përgjegjësi disiplinore. Masat disiplinore jepen nga eprori i drejtpërdrejtë, sipas legjislacionit përkatës.

Neni 28

Gjoba

1. Shkelja e neneve 16, 17, 18 pika 2 shkronjat “a” dhe “c” dhe 20 pika 3 të këtij ligji dënohen me gjobë nga Inspektorati Shtetëror i Punës.

2. Shkelja e neneve 24 pika 2 dhe 26 të këtij ligji përbën kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga Inspektorati Shtetëror i Punës.

3. Çdo person që shkel dispozitat e këtij ligji dënohet me gjobë si më poshtë:

- a) personi fizik, nga 30 000 deri 60 000 lekë;
- b) personi juridik nga 60 000 deri 100 000 lekë;
- c) personi fizik brenda personit juridik, i cili është përgjegjës për shkelje, nga 30 000 deri 80 000 lekë;
- ç) personi, i cili ushtron funksion publik dhe është përgjegjës për shkelje në bazë të këtij ligji, nga 30 000 deri 80 000 lekë.

4. Shkeljet e dispozitave të këtij ligji, në rastet kur përbëjnë vepër penale, dënohen sipas dispozitave të Kodit Penal.

Neni 29

Shpërblimi i dëmit

Shpërblimi për dëmin material dhe moral, të shkaktuar nga cenimi i dispozitave të këtij ligji, përfshirë rikthimin e të drejtave të shkelura, bëhet në rrugë gjyqësore në bazë të Kodit Civil.

Neni 30

Procedurat për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve

1. Çdo ankesë për shkeljen e barazisë gjinore, sipas këtij ligji, shqyrtohet ose gjykohet nga organet administrative, në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative. Organet administrative vendosin sipas dispozitave të këtij ligji.

2. Palët, sipas zgjedhjes së tyre të lirë, kur është rasti, mund të përmbushin çdo procedurë ndërmjetësimi ose të zgjidhjes me pajtim, të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, për të adresuar shkeljet në bazë të këtij ligji. Përmbushja e këtyre procedurave nuk i heq të drejtën ankuesit ta ndjekë çështjen pranë organit administrativ ose gjykatës kompetente.

3. Nëse shkelja është bërë nga nëpunësit e administratës publike, zbatohen dispozitat e ligjit nr.8510, datë 15.7.1999 “Për përgjegjësitë jashtëkontraktore të organeve të administratës shtetërore”.

4. Organizatat jofitimprurëse, të licencuara për ofrim shërbimi social, mund të përfaqësojnë ose të mbështesin në procese ligjore, në emër ankuesit, sipas parashikimeve të këtij ligji.

PJESA VIII

DISPOZITA PËRFUNDIMTARE

Neni 31

Shfuqizimet

Ligji nr.9198, datë 1.7.2004 “Për barazinë gjinore në shoqëri”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore, të dala në zbatim të tij, shfuqizohen.

Neni 32

Aktet nënligjore

1. Ngarkohet ministri që mbulon çështjet e barazisë gjinore për nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të nenit 13 shkronja “d” dhe të nenit 19 pika 4 të këtij ligji, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e tij.

2. Ngarkohet Këshilli i Ministrave për nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të nenit 11 pikat 1 dhe 4 të këtij ligji, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e tij.

Neni 33

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekreten nr.5850, datë 30.7.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 258 472 (Kryeredaktori)
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2008 është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 31.7.2008
Doli nga shtypi më 1.8.2008

Tirazhi: 3300 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja “Ilar”
Tiranë, 2008

Çmimi 36 lekë